

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.129 DHJETOR 2018



Ditë e bekuar



Faqe 4

Skicë nga Drizari



Faqe 8


TEQET SI OAZE QYTETËRIMI



Faqe 25

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHEMLITË TË
KRYEQJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR. 129 DHJETOR 2018



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR
Syrja Xhelaj

REDAKTORË
Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhamedi - Itali

KONSULENTË

Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

SHTYPET NË SHTYPSHKRONJËN

"Urtësia
Bektashiane"

Dhjetor, 2018

Duaje atë që do Zoti yt!

Duaje atë që do Zoti yt!

Ngjashmësi

Pas përvojave të mëparshme që kombinuan vështirësitë e thella me gëzimin e pa përshkruar, filloi lëvizja e fundit më e madhe e Muhamedit (s.a.s.). Ky ka qenë migrimi në Jethrib, qytetin që do quhej më vonë Madinat al-nabi ("Qyteti i Profetit") ...

vetën Medinën. Për parë keni përdorur analogjinë e Madës si zëmër e komunitetit islamik, veçorë në ditët e kaluara të kësaj periudhe. Në këtë analogji, nuk filloi Medinën të shprehë një moshë të re, por një moshë të re të cilës komuniteti i përkrahur për të inspiruar. Këtë përfaqësojnë ato që bëjnë pjesë të jetës së përditshme të muslimanëve, siç janë: imazhi i profetit, imazhi i Allahut, imazhi i Muhamedit (s.a.s.), imazhi i bashkësitë dhe imazhi i bashkësitë të profetit.

Medinë njëkohësisht ka qenë një vend i ri, një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij. Në këtë kuptim, Medinë ishte një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij. Në këtë kuptim, Medinë ishte një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij.

Medinë njëkohësisht ka qenë një vend i ri, një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij. Në këtë kuptim, Medinë ishte një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij.

Medinë njëkohësisht ka qenë një vend i ri, një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij. Në këtë kuptim, Medinë ishte një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij.

Medinë njëkohësisht ka qenë një vend i ri, një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij. Në këtë kuptim, Medinë ishte një vend i ri i krijuar nga profeti dhe bashkësitë e tij.

Pas përvojave të mëparshme që kombinuan vështirësitë e thella me gëzimin e pa përshkruar, filloi lëvizja e fundit më e madhe e Muhamedit (s.a.s.). Ky ka qenë migrimi në Jethrib, qytetin që do quhej më vonë Madinat al-nabi ("Qyteti i Profetit") ...

Mesazh nga kjo ditë e bekuar

Në përkujtimin e 191 vjetorit të themelimit të teqesë Turanit në Korçë kishin ditë që, mykhybanë dhe dashamirës të teqesë kishin organizuar punët, për të përgatitur këtë pelegrinazh të përvitshëm simbolik. Një ditë e shënuar në veprimtaritë e teqesë Turanit që është edhe qendra e Gjysbatës së Korçës, e cila ka në juridiksionin e saj...

14 Nr. 129 / Dhjetor 2018

Mesazh nga kjo ditë e bekuar

Në përkujtimin e 191 vjetorit të themelimit të teqesë Turanit në Korçë kishin ditë që, mykhybanë dhe dashamirës të teqesë kishin organizuar punët, për të përgatitur këtë pelegrinazh të përvitshëm simbolik. Një ditë e shënuar në veprimtaritë e teqesë Turanit që është edhe qendra e Gjysbatës së Korçës, e cila ka në juridiksionin e saj...



Skicë nga Drizari

Në atë dhomë të teqesë së dikurshme të Drizarit, ku erërat e ftohta të fillim-dhjetorit grinden me gurët e bardhë, 80 vjeçari Arshi Shehu më thotë duke më parë drejt në sy: Ajo kohë mos ardhte më. Ishte mortje për ne, jo për Zotin se ai ishte lart në qiej. Po ne na duhej të ishim në behar, s'kish dimër për ne...

14 Nr. 129 / Dhjetor 2018

Skicë nga Drizari

Në atë dhomë të teqesë së dikurshme të Drizarit, ku erërat e ftohta të fillim-dhjetorit grinden me gurët e bardhë, 80 vjeçari Arshi Shehu më thotë duke më parë drejt në sy: Ajo kohë mos ardhte më. Ishte mortje për ne, jo për Zotin se ai ishte lart në qiej. Po ne na duhej të ishim në behar, s'kish dimër për ne...



Nderim për këtë bektashi dijençor!

Në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut, nga sekretariati i shtetit shqiptar ishte vendosur midis të tjerave dhe kthimi në atdhe i eshtrave të personalitetit të shquar shqiptar Mid'hat Frashëri (1880-1949). ...

14 Nr. 129 / Dhjetor 2018

Nderim për këtë bektashi

Në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut, nga sekretariati i shtetit shqiptar ishte vendosur midis të tjerave dhe kthimi në atdhe i eshtrave të personalitetit të shquar shqiptar Mid'hat Frashëri (1880-1949). ...



DITURIA SI VLERË SUBSTANCIALE E BEKTASHIZMIT

Rrjedhat përmes të cilave ka ecur Rmendimi Islam kanë nxjerrë në pah më së shumti dëshirën dhe veprimin konkret për marrjen e diturisë, për kërkimin në të fshehtat e saj, qoftë edhe me çmime të larta të armiqësisë në karvanët e të paditurve. Për më tepër, nëse sjellim ndër mend

14 Nr. 129 / Dhjetor 2018

Dituria si vlerë substanciale e bektashizmit

Rrjedhat përmes të cilave ka ecur Rmendimi Islam kanë nxjerrë në pah më së shumti dëshirën dhe veprimin konkret për marrjen e diturisë, për kërkimin në të fshehtat e saj, qoftë edhe me çmime të larta të armiqësisë në karvanët e të paditurve. Për më tepër, nëse sjellim ndër mend



Mesazh nga kjo



Nga Nuri ÇUNI

Në përkujtimin e 191 vjetorit të themelimit të teqesë Turanit në Korçë kishin ditë që, myhybanë dhe dashamirës të teqesë kishin organizuar punët, për të përgatitur këtë pelegrinazh të përvitshëm simbolik. Një ditë e shënuar në veprimtaritë e teqesë Turanit që është edhe qendra e Gjyshitës së Korçës, e cila ka në juridiksionin e saj, rrethet Pogradec, Devoll, Bilisht, Korçë dhe Kolonjë. Me atë dashuri dhe përkushtim flet thjesht dhe qartë Nuri Muçollari, si sekretar dhe organizator i mirë i kësaj gjyshate. Ai flet edhe për shqetsimet, me vështirësitë që ka, në çështjen e pronave dhe legalizimin

e teqeve dhe tyrbeve të ringritura pas viteve 1990. Teqeja e Turanit është e rrethuar nga teqeja e Melçanit e Qatromit dhe tyrbet që ndodhen njëra pas tjetrës, e Bulgarecit, Pîrgut, Çaushtisë, Plasës, Sovjanit, Lozhanit, Malavecit e të tjera me radhë. Vijnë në mëngjesin e kësaj dite, të parët myhibët si: Gani Dilka, Flamur Lenja, Hasan Nako e dashamirësit, nga zonat malore Gorë-Oparë, Melçani, Bulgareci, qyteti i Korçës, Devolli, nga Tirana nga pushteti vendor si: nga Qarku i Korçës, Kryetari i Bashkisë, përfaqësues të komunitetve fetarë e të tjerë.

Myhibët e vjetër si: Gani Dilka nga Voskopi me respekt shpreh: "Dita më e mirë është sot, ditë e shënuar, nëna dhe babai im kanë qënë myhib të kësaj teqeje, ne sot si familje bektashiane jemi 10 vetë. Ai që vjen në këtë derë dhe beson,

o ditë e bekuar

Barjam Bardhi kishin ardhur enkas, duke bërë 70 km rrugë. Flamuri tregon: "se fshati jonë është i gjithë bektashi, sot janë 40 familje. Prindërit e mi shkonin rregullisht në teqen e Moglicës, por edhe në teqen e famshme të baba Feimit, në Vrëpckë. Ajo sot është kthyer në një rrënojë, se nga fshati janë larguar të gjithë vetëm tri familje janë sot. Përkujtimi i kësaj dite, 191 vjetori, na bënë krenar për historinë e teqesë dhe të gjithë udhërrëfyesit, baballarët dhe dervishët për rreth dy shekuj. E ndjejmë nevojën e klerikëve në fshatrat e largët". Edhe Hasan Nako flet me respekt për punën e bërë në teqen e Turanit mbas vitit '90, kjo duket nga punimet, rregullimet e përvitshme dhe mjedisi i këndshëm me gjelbërim e bëjnë të vizitueshëm edhe për të huajt. E shumë të tjerë besimtarë e dashamirët njëri pas tjetrit para se të filloj ceremonia e rastit, qetë dhe natyrshëm vijjnë e falen në tyrbet e teqesë, të cilat me hijeshin e tyre, si ndërtesa të bukura, mbajnë në kujtesë, shënjtërinë e baballarëve dhe dervishëve. Aty, me mezarët e njëpasnjëshëm në godinat e radhësuar me tre hyrje, japin dritë, në dritësimin e shpirtit të tyre, të dashurisë dhe përkushtimit me veprat e tyre. Përkushtim dhe dashuri ndaj Zotit dhe Krijuesit. Ata, lanë gjurmët e paharrura në historinë e teqesë të Turanit. Histori jo vetëm si gjyshatë, por histori e një kuvendi të madh, në shtator të vitit 1929,

di, se çështë teqeja, çështë besimi bektashian dhe çështë bektashizmi. Është detyrë e sejcilit nga ne, të ndihmojmë dhe të vijmë rregullisht në çdo veprimtari e ngjarje të teqesë. Sot jam 85 vjeç, por dashurinë dhe besimin në Zot e kam gjithmonë, jam bërë myhib nga baba Sabri Kalaja nga Skrapari. Kujtoj se Lufta e Dytë Botërore i shkatërroi teqetë dhe solli pasoja. Punoi dhe rihapi teqen mbas çlirimit

baba Zeqiri, e më pas erdhi baba Sabriu. Ky, e gjallëroi veprimtarinë e teqesë, bëri shumë myhib nga fshatrat përreth, rriti të ardhurat, në mbjelljen e arave, shtoi bagëtitë. Dera e teqesë ishte e hapur çdo ditë. Baba Sabriun e dëgjonin të gjithë, fjala e ngohtë, i qeshur dhe me dashuri i afronte të gjithë, si të krishterët dhe myslimanët. E kujtoj edhe sot, në vitin 1950, kur mblidheshim ne, djemtë e fshatit dhe punonim

vullnetarisht. Kornnim grurin në arat e teqesë, baba Sabriu na shtronte drekë të bollshëm, sa edhe e linim pa e mbaruar. Jo thosh babai! Hani, është për ju! Ta mbaroni, ashtu si korrët grurin! Për çdo nevojë për punë të teqesë, baba Sabriu u drejtohej të rinjve dhe besimtarëve, dhe ne ishim të gjithë të gatshëm, i qofshim falë."

Myhibi tjetër nga fshati i largët Moglicë, Flamur Lenja me shokun e tij 86 vjeçar



në teqen e Turanit, në statut dhe vendime e këtij kuvendi, për vendosjen e Kryegjyshit Botërore Bektashiane në Shqipëri me Kryegjysh Sali Niazi Dede. Kur u mbyllën teqetë dhe zavijet nga parlamenti turk më 13 dhjetor të vitit 1925, për këtë shkak Sali Niazi Dedei erdhi në Shqipëri. Histori kur u vendos provizorisht Qendra Botërore në teqenë e Turanit në janar të vitit 1930, erdhi vetë, Kryegjyshi i cili qëndroi rreth një vit, në këtë gjyshitë deri sa u vendos përfundimisht në kodrën e Shkozës, në afërsi të qytetit të Tiranës, të asaj kohe. Është edhe sot e kësaj dite një monument i gjallë si pjesë e historisë së bektashizmit botëror, rreth 90 vjeçare. Në oborrin e teqesë myhibët dhe dashamirsit duke parë ekspozitën fotografike flasin dhe kujtojnë veprat e baballarëve dhe dervishëve si baba Hajdari, dervish Filja i paepur në vitet 1914, kur adartët grekë pushtuan dhe bënë terror në gjithë Jugun e Shqipërisë. Për baba Zylfo Vërleri që u vra pabesisht. Për bashkëpunimin e teqesë së Turanit me teqetë e Melçanit, Qatromit, Starjes e Qesarakës të Kolonjës, Devollit dhe teqesë së Vrepckës në Gorë-Opar të Korçës. Veprat e tyre janë të shumta, ato mbetën monument në historinë e Shqipërisë.

Ashtu të qetë myhibët falen dhe luten me përkushtimin e tyre që kanë ardhur nga larg, ashtu me dashuri flasin, në kujtimet e tyre të hershme, ato që ndodhën në prishjen e teqeve nga sistemi komunist dhe puna e madhe nga gjithë besimtarët e dashamirësit që i ringritën nga themelet teqetë dhe tyrbet në gjyshitën e Korçës mbas vitit '90. Sepse bektashinjë shprehen se, punëmirët respektohen

dhe do të jenë të respektuar gjithë kohën nga të gjithë. Se kjo teqe, me histori, veç vepra të mira ka bërë gjithmonë, si për besimtarët, dashamirsit ashtu edhe për popullin, ata punuan si fetarë dhe atdhetarë. Në suret e Kuranit thuhet qartë: "se askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit... (Sure "En,am", ajeti 164) dhe kush bën mirë, e bënë për dobinë e vet dhe kush punon keq, e bën në dëmin e vet..." (Sure "Et Teubeb", ajeti 91), Ashtu siç thotë Haxhi Bektash Veliu: "Ne nuk i japim rëndësi kurrë fjalëve, por veprave të njeriut" dhe "Ne nuk shikojmë të jashtmen e njeriut, por të brendshmen e tij" këto mesazhe flasin qartë se duhet të bëjmë vetëm punë të mira dhe pastrimin e shpirtit për gjallërimin e zemrës. Sapo hyn në portën e teqesë, zbkurimi me flamuj dhe dekorin e thjeshtë, në mjedisin e mrekullueshëm, të kësaj teqeje, të ngoh dhe të jep zemër. Mirseardhjen do ta japi ngohtë dhe i qeshur Nuri Muçollari, në këtë kohë të ftohtë me shi. Ashtu, vendosur radhë dhe me kujdes standat nën strehën e teqesë, e cila është përgatitur ekspozita e plotë nga muzeologët e muzeut të bektashizmit në Kryegjyshitë. E cila tregon historinë e teqesë së Turanit, që e ka zanafillën e bukur të themelimit të saj në vitin 1827. Kjo ngjarje lidhet me kohën kur në teqen e Melçanit erdhën Sali Babaj dhe dervish Hasani, të cilët kishin tri vjet që rrinin te kushëriri i tij, Sulejman Karaj në Elbasan. Por baba Saliu me gradën gjysh që ka një histori të tërë, me veprat e mira që la në teqen Qypri-Turqi, autoriteti dhe prestigji i tij ishin njohur në Turqi dhe Shqipëri. Por e dogjën dhe e shkatërruan nga themelet, teqen e tij nga misionarët e Sulltan Mahmudit të II, në vitin 1826. Si udhërrëfyes, i madh dhe mistik, para se të vinte goditja për bektashinjë nga Sulltan Mahmuti i II-të, gjashtë muaj më parë, në një mbrëmje mbledhi gjithë dervishët e teqesë dhe u tha: "...Bij të mi! Siç e kam parë shënjen nga Piri, së afërmi do të vij koha që ne do të prishemi. Por kur të vij ajo kohë, ju të gjithë shkoni mysafirë te bejlerët e Plasës (afër Korçës) se ata janë evlatët tanë dhe ju mbajnë atje. Fakiri do të marrë dervish Hasanin dhe do të vete disa kohë te kushërinjtë e mi në Elbasan, sa të shkojë kjo kohë e turbullt." (Baba Rexhebi, Misticizma..., viti 2006, f. 364). Baba Abdullahi i teqesë së Melçanit, i njohur në shenjtërin e tij, i cili ishte gjysh e fton të rrinin nbashkë në teqen e Melçanit. Në këtë periudhë Sali Babai themeloi teqen e Turanit. Por, sipas kodit bektashian, kur ai, kaloi nga kjo jetë, u varros atje, si themelues i teqesë. Ardha e Kryegjyshit Botërorë të Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në këtë ditë ishte gëzim i veçantë, e rrethuan me respekt e dashuri myhibët dhe dashamirsit, në bisedën e ngrohtë te kafe oxhaku, në grohtësinë e zjarrit, ishte jo vetëm përkujtimi i kësaj ngjarje të rëndësishme, por Kryegjyshi interesohej për shëndetin, hallet dhe shqetësimet, e mbi punën e teqeve në gjyshitën e Korçës dhe si do zgjidheshin vështirësit dhe problematikat në këtë Qarkë. Me këtë rast u organizua ceremonia tradicionale ku në përshëndetjen e tij, Kryegjyshi u shprehmidis të tjerave: "Të nderuar autoritete të pushtetit vendor! Të nderuar vëllezër të mijë, përfaqësues të feve në Korçë! Motra dhe vëllezër besimtarë të bektashizmit! Më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë ditë peligrinazhi për teqenë e Turanit dhe së bashku me urimet e fundvitit, pranoni lutjen time të dalë nga zemra për ju dhe familjet tuaja. Qofshi kurdoherë pranë mësimëve të Zotit dhe pranë begatave që vijnë prej forcës së Tij!

Ditë të tilla peligrinazhesh, ndonëse ne i kemi të shpeshta në teqetë tona, kanë gjithmonë rolin dhe vendin e tyre të madh jo thjeshtë në kalendarin fetar por sidomos në idenë e ripërtëritjes

të besimit të cilit i përkasi. Në çdo përvjetor të teqeve, ne bëjmë sigurisht edhe bilancet shpirtërorë, takohemi dhe shmallemi me njeri-tjetrin, flasim me klerikë e myhibë, dëgjojmë hallet e besimtarëve dhe përpiqemi t'ju japim krahë shpresave të tyre. Sepse në fund të fundit, thelbi i traditave dhe praktikave tona fetare, nuk është gjë tjetër; veçse afrimi tek Krijuesi, tek vëllezëria për njeri-tjetrin, tek dashuria për kombin dhe familjen, tek burimet e kulluara të urtësisë emblematike bektashiane. Në këtë vend të shenjtë, 191 vjet më parë, pikërisht në këtë vend, baba Sali Elbasani do të vinte gurin e parë të themelit bektashian, të urtësisë dhe dritës që shpërndante mendimi aq i vyer i Haxhi Bektash Veliut. I ardhur së bashku me dy dervishët e tij, nga teqeja e Veleshtës në Maqedoninë e sotme, ky klerik i mençur e pati kuptuar se vetëm duke u mbështetur në bujarinë dhe zemërgjerësinë e korçarëve dhe fshatrave për rreth do t'i bënte ballë ofensivës turke të vitit 1826, e cila kërkonte eliminimin e plotë të tarikateve të Islamit. Kjo teqe hodhi shtat përmes varfërisë së atyre viteve, duke sfiduar ndërkaq edhe veprimtarinë e gjerë otomane për të mos lejuar rigjallërimin e tarikateve. Padyshim që roli i teqesë së Turanit do të vinte duke u rritur në fillimet e shekullit që lamë pas, në kulmin e lëvizjes autonomiste shqiptare. Ndonëse për hir të

largësisë nga qyteti i Korçës, si dhe pozicionit gjeografik, patriotët shqiptarë të kohës rregullisht mblidheshin në Melçan, në mbrojtjen e baba Hysenit, këtu në Turan, nën kujdesin e baba Hajdarit, mësonin çdo ditë gjuhën shqipe fshehurazi, dhjetëra djem të ardhur nga Korça e rrethinat. Gjithashtu prej myhibëve të baba Hajdarit, librat dhe abetaret shqip të ardhura nga Sofia, shpërndaheshin në Starje, Qesarakë, Leskovik dhe deri në Alipostivan të Përmetit. Klerikët e kësaj teqeje, së bashku me klerikë të tjerë përparimtarë myslimanë dhe të krishterë të qytetit, ishin në radhët e para të atdhetarëve për përhapjen e shkronjave dhe të librave shqip. Unë besoj se në memorien e korçarëve do të mbahen mend gjatë manifestimet madhështore të qytetit deri në mijëra vetë, në mbrojtje të gjuhës shqipe. Falë urtësisë, fisnikërisë dhe dijes së thellë të baba Hajdarit, si edhe dervishëve që i rrinin pranë, teqeja e Turanit nisi të rritej dita-ditës, jo vetëm me myhibë të devotshëm që vinin nga Struga dhe Veleshta, por dhe me dashamirës të flaktë të fshatrave të Korçës

. Ata merrnin në oborr të kësaj teqeje jo vetëm shpresat që ngjall besimi në Zot, por dhe kurajën për të mbajtur në shpirt shqiptarizmin e thellë. Për hir të së vërtetës, vlen të kujtojmë sot se, baba Hajdari, në vitet e vështira 1913-1915, atëherë kur teqetë e jugut të Shqipërisë po digjeshin prej andartëve grekë, shkoi në Amerikë ku punoi vetë disa kohë, në punët më të vështira. Prej këtej, me ato para që fitoi me djersë, si edhe me ndihmën e atdhetarëve korçarë myslimanë dhe të krishterë, erdhi në Turan dhe me ndihmën e Zotit të Lartë, dalëngadalë e mbushi teqenë me besimtarë, zhvilloi më tej të ardhurat, duke qenë kurdoherë mbështetës i ndjenjave të kulluara patriotike të korçarëve. Pas rritjes së besimit bektashian në trevën e Korçës dhe veçanërisht atdhetarizmit të dukshëm të klerikëve, me të drejtë nga baballarët më të shquar të asaj kohe, u vendos që Kongresi i Tretë Bektashian të mbahej në teqenë e Turanit, duke i shtuar asaj një tjetër vlerë historike. Të ardhur nga Kosova e Maqedonia, nga Greqia dhe Çamëria, klerikët bektashianë shqiptar u mblodhën në tetorin e vitit 1929 në Kongresin e Tretë të tyre, i cili për nga idetë që shtroi dhe objektivat që zgjidhi, shënoi çastin e madh historik, atë të mëvehtësimit prej tendencave aneksuese, si dhe të vendosjes në Shqipëri të Qendrës Botërore Bektashiane, pas përpjekjeve disa vjeçare të Sali Niazi Dedesë. Kongresi u prit me entuziazëm të thellë nga krejt besimtarët bektashianë në trevat shqiptare në Turqi, Egjipt dhe deri në Amerikën e Largët. Edhe në vitet që rrodhën më pas, teqeja e Turanit do të vijonte të afronte sa më shumë dashamirës, duke dhënë impulse të reja besimit bektashian, duke ndjekur traditën e vyer, por gjithsesi, duke pasur parasysh që doktrina jonë t'u shërbente besimtarëve në thelbin e vet, në devocionin ndaj Krijuesit, pa u ndarë prej halleve apo dramave që kalonte Korça dhe gjithë Shqipëria. Në vitet '30 të shekullit që lamë pas, në krye të kësaj teqeje vendoset një tjetër klerik i shquar, baba Zylfo Vërteni, nipi i baba Hysen Melçanit dhe atdhetar i radhëve të para. Një varg veprimtarish të mrekullueshme fetare, jo vetëm në Turan por edhe në Qatrom, Melçan, Starje dhe deri në Përmet, mbajnë kolonat e mendimit të tij të thellë, përpjekjet për të gjallëruar shpirtat përmes dashurisë për atdheun. Në vitin 1930, baba Hajdarin e ka vizituar veç studiuesve të tjerë të huaj edhe Xhon Bërxi, i cili në veprat e tij, ka lënë të shkruara mbresat e pashlyera prej klerikut



tonë dijeplotë. Ngjarja e hidhur e vitit 1943, vrasja e këtij kleriku në teqe prej forcave të komanduara nga emisarët jugosllavë të Titos, është veç të tjerave një dëshmi e veprës së tij të pastër në shërbim të Zotit dhe Shqipërisë. Edhe një herë ju uroj më shumë dashuri për njeri-tjetrin, më tepër miqësi e mbarësi, më shumë dashuri tek Krijuesi! Zoti u bekoftë të gjithëve! Dhe më pas Kryetari Bashkisë z. Sotiraq Filo uroi këtë ditë të shënuar dhe sollti në vemendje gjurmët e baballarëve për rolin fetar dhe atdhetar, bashkëpunimi i tyre dhe tolerancën fetare në qytet dhe fshat kanë ndihmuar në harmoninë në popull dhe u jemi mirënjohës për të. Kryetari dhe Këshillit të Qarkut Korçë, znj. Ana Veriski falenderoi Kryegjyshin, në këtë ditë pelegrinazhi, përkujtimin e kësaj ngjarje, themelimit e teqesë. Përkushtimi baballarëve dhe dervishve në shekuj për besimin e bektashian është i madh dhe nuk harrohet në trevën e Korçës. Arsyja dhe zëri i tyre ishte i pranishëm në popull si dje dhe sot, të cilët janë më të hapur dhe të ndërgjegjshëm në punët e tyre fetare dhe dashurinë për atdheun, urime dhe gëzuar festën!” Përfaqësuesi i ortodoksve, i cili falenderoi Kryegjyshin, Haxhi Dede Edmondin për ftesën, uroi të gjithë pjesëmarrsit për shëndet dhe mbarësi. Në takim me Kryegjyshin përfaqësuesi i komunitetit mysliman i uroi gëzuar ditën e shënuar, biseda e ngrohtë dhe me dashuri u sollën ngjarje dhe puna vetmohuese e klerikëve bektashian në historinë e Qarkut të Korçës. Me intelektual dhe të tjerë bisedat vazhduan deri mbasdite, në regjistrimin bektashian, punën në arkivat për të nxjerrë në pah historinë e bektashizmit në shekuj, historikë të teqeve dhe tyrbeve në Korçë, Kolonjë, Bilisht, Devoll, Pogradec, që ka shumë për të bërë. Plotë gëzim dhe dashuri ishin dhe takimet me baba Faik Selmani, devish Admirin, të ardhur nga Elbasani dhe dervish Sali Peti, i cili erdhi nga Vlora. Me dashurinë e ngrohtësinë e kësaj dite dhjetori, Kryegjyshi u dha urimet më të mira për festat e fundvitit. Sejcili pelegrinë mori me vehte mesazhin e kësaj dite të shënuar, çiltërsinë dhe ndenjen e punëmirë, në mirësi dhe dashuri ndaj Zotit në lartësimin e shpirtit.



Skicë nga D

Në atë dhomë të teqesë së dikurshme të Drizarit, ku erërat e ftohta të fillim-dhjetorit grinden me gurët e bardhë, 80 vjeçari Arshi Shehu më thotë duke më parë drejt në sy: Ajo kohë mos ardh të më. Ishte mortje për ne, jo për Zotin se ai ishte lart në qiej. Po ne na duhej të ishim në behar, s'kish dimër për ne. Më vonë, shumë kohë më vonë, e mësuam se ideologjitë ishin si ata vijat e ujit në korrik, që humbnin në çast dhe ti habitesh se ku e fshehu toka e tharë. Ndërsa këngët e Haxhi Bektashit mbetën. Mbetën edhe fjalët e mençura të dede Ahmetit siç mbeti dhe kopshti i stolitur i teqesë nga duart e arta të dervish Reshatit. Siç ka mbetur kjo arrë e madhe që kur vinim në korrik apo gusht, uleshim, pranë babait a dervishit dhe qanim hallet aq lehtë, sa nuk i qanim as me vëllezërit që na kishin lënë nëna dhe babai.

Unë e pyes dhe sërish Arshiu, pa mi ndarë sytë më tregon: “Një javë para se të prishej teqeja, dede Ahmeti kërkoi të takonte disa komunistë. Ishte përhapur fjala nga disa të rinj të fshatit se babai e dervishi do të përcilleshin me fizarmonikë e do qesëndiseshin nga rinia sepse kishin mashtruar popullin duke shpërndarë opiumin e fesë. U mblodhën katër-pesë burra. Shkova edhe unë. Ne drizarasit e kishim dashur teqenë. Ishim rritur me bekimin e baballarëve. Shumë nga të rinjtë, kur u dilte e drejta e studimit për në

Universitetin e Tiranës, shkonin në teqe dhe bashkë me fjalët e ngrohta të dede Ahmetit, merrnin edhe ndonjë para për t'u veshur se ishin të varfër. Ato lekë s'u kthyen kurrë në teqe dhe baballarët thoshin: Hallall, vetëm t'i venë veshin shkollës?

Kur po mbaronte biseda, njëri prej nesh i tha me gjysmë zëri dede Ahmetit: "Të keqen baba, çfarë do të bëjë rinia, vetëm mos i mallkoni!". Ky buzëqeshi dhe na u kthye të gjithëve: "Ne baballarë e dervishë jemi në këtë botë për të shëruar plagë dhe jo për të hapur plagë. Mua dhe dervish Reshatin, po na muartë para me gurë, mos kini frikë se nuk mallkojmë dot njeri. Ama, frikë nga Ai lart duhet të kini. Sepse nuk e di a do të venë deri atje lutjet tona për ju, apo jo, ky është hall më vete."

Kaluan disa muaj nga shkurti i vitit 1967 dhe dëgjohej ndonjë i mjerë që thoshte për t'u dukur: "Ja e rrënuam teqenë, e zhdukëm fare tyrben. Pse s'na zuri

Ne drizarasit e kishim dashur teqenë. Ishim rritur me bekimin e baballarëve. Shumë nga të rinjtë, kur u dilte e drejta e studimit për në Universitetin e Tiranës, shkonin në teqe dhe bashkë me fjalët e ngrohta të dede Ahmetit, merrnin edhe ndonjë para për t'u veshur se ishin të varfër. Ato lekë s'u kthyen kurrë në teqe dhe baballarët thoshin: Hallall, vetëm t'i venë veshin shkollës?

Kur po mbaronte biseda, njëri prej nesh i tha me gjysmë zëri dede Ahmetit: "Të keqen baba, çfarë do të bëjë rinia, vetëm mos i mallkoni!". Ky buzëqeshi dhe na u kthye të gjithëve: "Ne baballarë e dervishë jemi në këtë botë për të shëruar plagë dhe jo për të hapur plagë."

mallkimi i baballarëve?". Mua më vinte keq edhe për atë bashkëfshatar por edhe për baballarët, se mbaja ndër sy fjalën e dede Ahmetit. Por ne mallkimi na vinte nga larg, nga shumë larg. Kur mbillinin grurë dikur, dërgonim nxënësit e shkollave me aksion për të pastruar bimën e shëndetshme nga një lloj bime tjetër që i merrte ushqimin dhe që quhej në gjuhën popullore krisje. Ajo kohë që mos ardhte kurë, po na shkulte nga shpirtrat tanë bimën e mirë, besimin në Zot dhe na linte vetëm krisjet."

Në bisedë bashkohet me ne paskëtaj Edmond Lika, Qazim Elmazaj, Bashkim Jonuzi dhe Fetah Xhemalaj. Më bën përshtypje xha Fetahu. Ka marrë rrugën i vetëm nga Vlora, me disa qirinj në duar dhe dy trëndafila të freskët. Trëndafilat i vendos aty, ku dikur ishte dhoma e fjetjes së dede Ahmetit dhe dervish Reshatit, ndërsa qirinjtë i ndez në mezarët e baballarëve në tyrbe. Ka plot kujtime nga kjo teqe por hesht. Nga një herë, heshtja flet me gjuhën e saj,

më shumë se mijëra biseda të bëra së bashku. Më ngjanë së duke lëmuar gurët e vjetër të teqesë së rrënuar, duart e tij takojnë me ato të klerikëve që i ka dashur aq shumë. Dhe në atë takim aq të beftë e të përmallshëm, vetëm erërat e nëntorit mund t'i kuptojnë fjalët e pathëna midis tyre.

Avdi Salaj nuk më fsheh shqetësimin. Ai mbanë mend se dervish Reshati, brenda dy-tri viteve të parë që pati ardhur këtu në Drizar, shartoi rreth 70 gorrica të egra me dardhë dhe, në muajt prill, kurora e bardhë e tyre i rrinte teqesë si një mjegull e palëvizshme. Lëri pastaj mollët, bajamet, fiqtë. Ndërsa tani, përveç arrës dhe dy-tri fiqve, gjithçka është shkretë. "Duhet rrethuar vendi. Të dihet se është tokë e teqesë dhe të mos jetë ky vend i begatë si mall pa zot. Pas rrethimit, ja do vijmë me radhë, ne që e patëm jetuar kohën e bekuar me baballarë. Dikush do të mbjellë dy-tri ullinj, di-

kush dy-tri dardhë, dikush dy-tri bajame. Do t'i mbjellim dhe verselitim vetë. Të kthehet toka e teqesë siç ka qenë, se ishim të vegjël dhe në behar kur çonim gjellë apo bukë në teqe, për baballarët, çantat vinin prapë plot e përplot në shtëpi, nga frutat, ndërsa tani shkon në teqe, e s'gjen as karamelle."

Rikthimi i këtij vendi në lavdinë e dikurshme, nuk ka të bëjë aspak me egon njerëzore. Më tepër se kaq, mendoj se ka të bëjë me lëndën shpirtërore, me atë ndjesi të veçantë gati fluide që të mbush qenien në zbrastirën më të skajshme, duke ndriçuar skutat e errëta. Bota e sotme, pavarësisht mrekullive të shkencës, pavarësisht joshjeve që ofron, dëshmohej të ecë nëpër terr, nëse nuk bëhemi merak për shpirtrat. Për at, të vrarët dhe të lodhurit e djeshëm. Për këta, shpirtrat e sotshëm, tek e mbramja, po e kuptojnë dalëngadalë se duhet dikush t'i paqëtoj në udhëtimin e shkurtër në këtë botë, t'i afrojmë e vëllazërojmë për të ndërjerë së brendshmi shkulmet e dallgëve të detit të Tij.

Syrja Xhelaj, Drizar,
nëntor 2018

Nderim për këtë b

**Kryegjyshi Botëror Bektashian,
Hirësia e Tij,
Haxhi Dede Edmond Brahimaj,
merr pjesë në ceremonialin e
kthimit në atdhe të eshtrave
të atdhetarit të madh dhe
bektashiut të shquar Mid'hat
Frashëri, në Nev Jork dhe Tiranë**

Në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut, nga sekretariati i shtetit shqiptar ishte vendosur midis të tjerave dhe kthimi në atdhe i eshtrave të personalitetit të shquar shqiptar Mid'hat Frashëri (1880-1949). Ndonëse midis debatete të nxeha politike, sidomos në Tiranë, rrugëtimi i eshtrave të këtij burri të madh të kombit tonë nisi përtej oqeanit, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Shkëlqesisë së Saj Floreta Faber, Ambasadore e Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe z. Toma Frashëri, kryetar i sekretariatit të vitit mbarëkombëtar të heroit. Me ftesë të këtyre organizatorëve të nderuar, udhëtoi drejt Nev Jorkut edhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

Në mëngjesin e datës 10 nëntor, Kryegjyshi Botëror i Bektashin-



**Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij,
Haxhi Dede Edmond Brahimaj:**

... Më vjen mirë t'ju kujtoj sot, se në mesin e mijëra faqeve të shkruara me dorën e tij, të cilat sot ruhen me aq kujdes në fondet e Arkivit Qendror të shtetit shqiptar, gjendet midis të tjerave edhe një letër që i dërgon baba Selimit, në teqenë e Zallit në Gjirokastrë, në të cilën e bën me dije se ka blerë disa rrënjë ulliri në Tiranë dhe ja ka dërguar për t'i mbjellë atje. I tillë ishte ky burrë i kombit. Bisedonte me albanologët më të shquar të atyre viteve, me politikanë dhe shtetarë të huaj, me mbretër e diplomatë, po gjente kohë të kujdesej edhe për bahçet e teqesë.

Bektashi dijeplotë!

jve mori pjesë në ceremoninë familjare të nxjerrjes së eshtrave të Mit'hat Frashërit ku bëri lutjen e rastit. Më tej në qendrën "Nënë Tereza" në Nev Jork, pranë Kishës së Zonjës së Shkodrës, në prani të qindra personaliteteve të ardhura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëria, Kosova, Kanadaja etj, Kryegjyshi Botëror u prit përzemërsisht nga Ambasadorja Faber, e cila, pasi i uroi mirëseardhjen, e njohu me pjesëtarë të tjerë organizatorë të këtij ceremoniali.

Një bisedë të ngrohtë, Kryegjyshi Botëror Bektashian zhvilloi gjithashtu me Dr. Skënder Myrtezani, udhëheqës i Federatës Pan-shqiptare "Vatra" për Nev Jorkun, duke e falënderuar për misionin e shkëlqyer që kjo organizatë po kryen në SHBA, si në mbajtjen gjallë të traditave të vyera të kombit shqiptar, ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarive të larmishme me karakter mbarëkombëtar. Nga ana e tij, Dr. Myrtezani, vuri në pah rolin e teqesë bektashiane në Detroit –Michigan, e cila prej më shumë se gjashtë dekada, ka shërbyer dhe shërben si një qendër e vlerave atdhetare dhe besimi në Zot, duke përhapur dritë diturie dhe vëllazërie midis komuniteteve të religjioneve të ndryshme ndër shqiptarët e Amerikës.



Një pritje të ngrohtë i kanë rezervuar Kryegjyshit Botëror Bektashian edhe liderët shqiptarë të komuniteteve fetare myslimanë, ortodoksë dhe katolikë të SHBA, të cilët duke e falënderuar për pranimin e Tij, kanë theksuar edhe një herë rolin e pazëvendësueshëm të Selisë së Shenjtë Bektashiane me qendër në Tiranë, si në kontekstin e harmonisë dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri, ashtu dhe në mbajtjen gjallë dhe zhvillimin e vlerave tona kombëtare. Tarikati bektashian, theksuan ata, ka qenë dhe mbetet pasuri e Islamit jo thjeshtë për mesazhet e paqes që përcjell, por edhe për qëndrimin e sotshëm në krah të ideve për ura bashkëpunuese, në luftë me çdo lloj radikalizmi apo politizimit të

doktrinave fetare.

Pas fjalëve përshëndetëse, të cilat evokuan jetën dhe veprën e Frashërllit të shquar, e mori fjalën edhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili në vijim të lutjes ceremoniale bektashiane, vijoi: "...Është kënaqësi e veçantë për mua personalisht, që të marr pjesë në këtë ceremoni përkujtimore dhe t'ju përshëndes të gjithëve në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian. Paçi fat e mbarësi në familjet tuaja të bekuara!

E quaj gjithashtu veten me fat që më jepet rasti të them dy fjalë mirënjohje të thellë për Mit'hat Frashërin, këtë personalitet të shquar shqiptar, emri i të cilit, në shekullin e kaluar u përcoll me

respekt jo vetëm ndër shqiptarët, kudo që ishin, por edhe në rrethet më të shquara të miqve të Shqipërisë. Ky bir biologjik i Abdyl Frashërit, ky nip dhe nxënës i Samiut dhe Naimit, që në fëmijërinë e parë të tij, u rrit dhe u edukua me dashurinë e pakufi për atdheun, me frymën shenjtërore të vatanit, të cilit duhej ti përgjigjej në çdo kohë dhe me çfarëdo sakrifice. Ai

e shkua. Si rrallëkush në historinë e mendimit shqiptarë të kohërave që jetoi, ky albanolog i thellë, ky bibliograf i madh, ky diplomat i përkushtuar ndaj fateve të kombit, ky atdhetar i dorës së parë, kurdoherë u gjend në radhën e duhur të burrave që bashkë-ndanë jetën fizike dhe shpirtërore me stuhitë që kalonte Shqipëria. Por vlen të kujtojmë sot, të nderuar

të cilat sot ruhen me aq kujdes në fondet e Arkivit Qendror të shtetit shqiptar, gjendet midis të tjerave edhe një letër që i dërgon baba Selimit, në teqenë e Zallit në Gjirokastrë, në të cilën e bën me dije se ka blerë disa rrënjë ulliri në Tiranë dhe ja ka dërguar për t'i mbjellë atje. I tillë ishte ky burrë i kombit. Bisedonte me albanologët më të shquara të atyre viteve, me politikanë dhe shtetarë të huaj, me mbretër e diplomatë, po gjente kohë të kujdesej edhe për bahçet e teqesë. Prandaj bashkohem sot me të gjithë bashkë-kombasit e mijë, në nderimin e thellë që i bëhet këtij personaliteti të vyer, në ceremonialin më të natyrshëm për ta kthyer atë në vendpreshjen e duhur, në atdheun që e deshi dhe u sakrifiku. Duke nderuar Mid'hat Frashërin, në të vërtetë ne nderojmë brezat e atyre që rilindën Shqipërinë. Zoti e bekoftë tokën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që mbajti Mid'hat Frashërin tonë! Zoti na bekoftë të gjithëve! Amin!"



mbajti brenda vetes dhe transmetoi në çdo punë e vepër të tij, deri në çastin kur mbylli sytë, vlerat pafund të Frashërlinjeve, të atyre burrave që udhëhoqën historinë tonë në kundërshtim me nderet apo ofiqet që u propozonte Porta e Lartë. Mid'hat Frashëri ka qenë vetëm 17 vjeç kur iu përkushtua çështjes shqiptare dhe udhëtimi i tij, deri në fillim-tetorin e vitit 1949, nuk është gjë tjetër, veçse një triumf i vlerave më të kulluara të shqiptarizms. Ndonëse në rrethana të ndryshme dhe në kohëra të ndryshme, këto ide u anatemuan prej qarqeve antishqiptare, sërish ato ruajtën identitetin e tyre, margaritarin e çmuar të dashurisë dhe veprimtimit për atdhe të denjë, për familjen europiane me të cilën bashkëjetoi në shekujt

të pranishëm, se Mid'hat Frashëri ishte dhe mbetet një bektashi i madh. I madh jo vetëm në kuptimin e prejardhjes së tij, por sidomos të perceptimeve personale dhe nismave të tij në lidhje me tarikatin bektashian. Si drejtues i revistës "Liria" që dilte në Selanik në vitet 1908-1912, ai pati ngritur lart zërin e teqeve tona në Konicë, Katerinë, Janinë, Kostur dhe deri në Volos, në të famshmen të teqesë të Durballis-Sulltanit. Si Ministër Fuqiplotë në Athinë, ai u kujdes që teqetë bektashiane, sidomos në viset e Çamërisë të mos shkatërroheshin, sikundër pati takime në vitet '30 edhe me Kryegjyshin Bektashian të sapo ardhur në Shqipëri, Sali Niazi Dedenë. Ndërkaq, më vjen mirë t'ju kujtoj sot, se në mesin e mijëra faqeve të shkruara me dorën e tij,

Më 14 nëntor, eshtrat e Mid'hat Frashërit iu bashkuan përfundimisht atyre të Naimit dhe Abdylit, në memorialin e vëllezërve Frashëri, në kodrat e liqenit artificial të Tiranës. Në këtë ceremonial, Kryeminsitri Rama u shpreh midis të tjerave: "... "Në u dashtë të vdesësh, pa kurrfarë pengje mbetur, / Do të doja të ndodhte n'at muzg, ku Lavdia shpaloset mbi shtratin e fjetur, / Dhe Mëmëdhenë mes gëzimesh, mes të kremtesh më rrëfen". Kështu shkruante 110 vjet më parë, një djalosh i quajtur Charles de Gaulle, i cili në një moshë më të pjekur do t'i jepte shumë çështjes së lirisë, qëndresës ndaj armiqve të saj dhe vetëvendosjes së kombeve. E



tamam atëherë kur u hartuan ato vargje, një tjetër djalosh, i quajtur Mid'hat be Frashëri gjente një copë mëmëdhe në Manastir, ku kryesoi edhe të parin kongres mbarëkombëtar shqiptar për një alfabet të njehsuar. Ja se çfarë mund të lexohet rreth asaj ngjarjeje madhore të historisë sonë, në gazetën “Liria”, që vetë Mid'hat Frashëri e nxirrte në Selanik: “Le të them këtu ç’ është qëllim’ i kësaj mbledhje. Librat Shqip që kanë dalë gjerë më sot s’janë shtypnë të gjitha me një lloj abece. Në Toskëri të terë dhe në shumë vise në Gegëri, tekdo ku këndohetë shqipja dhe prej gjith atyre që kanë dëshirë për gjuhë të tyre, përdoretë abeceja me të cilët po shkrojmë dhe në gazetenë tënë, kësaj abeceje i thonë dhe e Stambollit, se aty tridhet vjet më parë duallë në shesh këto shkronja. N’ anë tjetër në Shkodrë përdorinë tri abece: e jezuitve, e Bashkimit dhe e Agimit. Abeceja e parë përdoret që këtu e 300 vjet; e Bashkimit doli në shesh nja 10 vjet më parë dhe ajo e Agimit 5 vjet më parë.

Kryeminsitri Rama u shpreh midis të tjerave:

Në Frashërin e vëllazërisë unike ndërfetare dhe osmozës së veçantë farefisnore, ky djali i Abdylit mori nën vezullimin e një drite, e cila nuk njihete asokohe përëndim, qumështin e parë të dijes universale dhe të vetëdijes kombëtare. “Që në djalëri t’eme”, - shkruan Mid’hati – “që kur se mbaj mend, kam dëgjuar në shtëpi fjalë për Shqipërinë, dua të them, bisedime mbi të drejtat e saj, fjalime që dilnin nga parimi i kultit të mëmëdheut, që buronin nga dashurija për Shqipërinë dhe nga detyrat e çdo shqiptari për truallin e vet. Këto dëgjova të parën herë kur fillova të flas, atëhere që qeshë dy vjeç në Frashër dhe më vonë, në Janinë, nga mama ime, nga gjyshi.

Tani Kongresi që po mbledhetë në Manastir do të kërkojë që të kupëtohetë bota për të përdorurë një të vetëm abece dhe të lihenë me nj’ anë të tjeratë. Shprehim fort shumë që më vullnet të mirë dhe duke u mejtuarë me paanërisht Kongresi t’ apijë në qëllim dhe t’ apë gjithë pemëtë që duhetë.”

Për ta kryesuar atë Kongres, Mid’hat Frashërin, parafytyrojeni, e zgjedhin dhe e ftojnë në mungesë 32 delegatë nga të gjitha viset dhe kolonitë shqiptare ndër të cilët Mjeda, Luigj Gurakuqi, Bajo Topulli, Fehim Zavalani, Shefqet Frashëri, Gjergj Qiriazhi, Shahin Kolonja, Thoma Avrami, që e lusin çunakun

nga Stambolli të vijë dhe të zërë fronin e nderit, një fron që ndoshta, madje jo ndoshta, me siguri secili prej delegatëve e meritonte, në mos edhe e mëtonte. Përse vallë, djaloshi u bë figura e konsensusit mes atyre burrave emërshquar dhe përse kur e pranoi si i zënë ngushtë atë barrë, e tërë paria e Kongresit u ngrit ta priste në stacionin e Manastirit me nderimet që iu bëhen krerëve të kombësisë? Kush ishte ky djalosh që më vonë do të hynte në historinë e shqiptarëve si një hije plot dije, me një identitet të dyfishtë, njërin, Lumo Skënderon për tempullin e letrave, tjetrin, Mid'hat Frashërin për staturën e shtetarit nën mantelin e politikanit me cen në biografi dhe që në fund fare, edhe në banesën e fundme do të qëndronte për shumë kohë si një jabanxhi nën dhe të huaj, sepse i papranuar për 7 dekada në nëndheun e atdheut të tij? Ky ishte si fillim, i vetmi djalë që tallazet dhe të papriturat e jetës i lanë Abdyl Toskës, siç e quan Fishta në Lahutën e Malcis njërin prej 3 vëllezërve të mrekullueshëm të historisë së shqiptarëve, Abdyl Frashërin. Frashërlintë njiheshin si “halimë”, pra, njerëz të diturisë në më të shquarën qytezë të Shqipërisë, në Frashër, një vend i barabartë me “Mekën e Arabisë e Betlehemin e Krishtërisë”, sipas Mihal Gramenos. Në Frashërin e

vëllezërisë unike ndërfitare dhe osmozës së veçantë farefisnore, ky djali i Abdylit mori nën vezullimin e një drite, e cila nuk njihete asokohe përëndim, qumështin e parë të dijes universale dhe të vetëdijes kombëtare. “Që në djalëri t’eme”, - shkruan Mid’hati – “që kur se mbaj mend, kam dëgjuar në shtëpi fjalë për Shqipërinë, dua të them, bisedime mbi të drejtat e saj, fjalime që dilnin nga parimi i kultit të mëmëdheut, që buronin nga dashuria për Shqipërinë dhe nga detyrat e çdo shqiptari për truallin e vet. Këto dëgjova të parën herë kur fillova të flas, atëhere që qeshë dy vjeç në Frashër dhe më vonë, në Janinë, nga mama ime, nga gjyshi. Kur vamë në Stamboll, kjo mënyrë kuvendimi vazhdoi prej ungjëvet të mij. Isha pesë vjeç kur e njoha për herë të parë tim atë, kur u fal prej burgut, por që akoma i dënuarë me mërgim. Im atë fliste mirë, që elokuent, i pëlqente bisedimi. Kështu që ca e nga ca, mëmëdheu mori për mua formën e një përëndie dhe kulti i tij mori për mua vendin e një besimi fetar. Po bashkë me adhurimin e tij dhe fare e pandarë zinte vent edhe çdo cep i pandarë i Shqipërisë, që mua më dukej si një trup i gjallë”. “Ky besim fetar”, - shkruan sërish Mid’hati, - “kishte gjetur rastin të më hynte në zemër; kulti i tij gjente pra një vend fare të lirë që të zhvillohet dhe të rritet çpunguar”.



...I pirur që në krye të herës të vetëvritet politikisht dhe shoqërisht, Mit'hat Frashëri nuk i negocion bindjet e tij. Në Vlorë e izolojnë, e nxjerrin madje nga shtëpia e siç e dëshmon vetë, pa të ardhura, rron me dy këmisha me jakë të ngrirë celuloze, një xhaketë angleze dhe dy palë veshmbathje. Është pikërisht ai që e cilëson me një anakronizëm profetik, lëvizjen haxhiqamiliste si shfaqjen e parë të lëvizjes bolshevike në Europë dhe po ai që lëshon alarmin, duke u bërë një nga pararendësit e ruajtjes së trashëgimisë kulturore për rrezikun e humbjes së vlerave tona kombëtare. "Çdo njeri që mendohet pak e që kujdeset për rrojtjen e këtij vendi të mjerë, dëshiron të shohë të mbështillen e të vihen në rregull makar ato gjëra të paktë që kanë mundur të shpëtojnë nga zjarri e nga armiqësia e njerëzve, të mos lihen në dhëmbët e minjve ose në pikat e lagështirës." Tri dekada më vonë është përsëri ai, që pa marrë parasysh drobitjen që i sjell mërgimi, vë kusht - dhe këtë është mirë ta dëgjojnë të gjithë ata, që pasi e kanë baltosur për shtatë dekada, sot mbajnë në injorancë buzët rrudhur, - vë kusht spastrimin e figurave të kompromentuara me pushtuesit nazifashistë nga çdo ndihmë politike dhe aktivitet kundër regjimit komunist të Tiranës. Mit'hat Frashëri ishte mishërimi i një shërbestari të mëmëdheut sipas kokës së tij. Sa herë që qarqe të caktuara, brenda apo jashtë vendit, yshtnin këtë apo atë taraf, fetar, social apo politik, në Shqipëri, për të mbjellë përçarjen, ai shfaqej menjëherë si armiku i tyre natyral. Është ai që nxjerr në pah, më shumë se kushdo tjetër, rolin madhor dhe esencial të elitës së krishterë ortodokse

shqiptare në luftën për Pavarësi, në dy broshura, "Popullsia e Epirit" dhe "Çështja e Epirit", ndërkohë që autorë të tjerë të së njëjtës sërë, por jo të të njëjtit ideal, e shtrembëronin realitetin për të lehtësuar copëtimin e vendit. Të lë pa frymë pozicionimi i tij për vënien në sytë e botës së qytetëruar të dramës, të tragjedisë së popullive myslimane dhe shqiptare të Çamërisë, të zhveshura e të zvetënuara nga çdo e drejtë themeltare, njerëzore dhe materiale, vetëm për shkak të etnisë dhe të besimit të tyre. Raportet e tij si ministër fuqiplotë në Athinë dhe beteja e tij juridike dhe politike në Lidhjen e Kombeve për mbrojtjen e këtyre të drejtave, nuk e shfaqin Mit'hat Frashërin vetëm si mbrojtës të elementit shqiptar të keqtrajtuar jashtë kufijve, por edhe si një flamurbajtës të shënuar, të të drejtave të minoriteteve, të dinjitetit të njeriut, të lirive të tij themelore, pa dallim etnie, pa dallim feje. Shumë prekës - këtë përsëri duhet ta dëgjojnë, të gjithë ata të të cilëve sytë, hundët, goja, veshët u janë taposur me baltë nga 70 vjet propagandë karikaturizuese për Mit'hat Frashërin, - është homazhi i tij ndaj rinisë shqiptare dhe luftës së saj kundër armikut dhe po ashtu nderimi që ai i bën, fjalët e tij, 30 mijë dëshmorëve të atdheut, ndonëse sipas tij, liria e Shqipërisë u uzurpua pas kësaj lufte.

Në ceremonialin në fjalë mori pjesë dhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili në fillim të ceremonialit shtetëror gjithashtu bëri një lutje sipas ritit bektashian pranë arkemortit të bektashiut dijeplotë Mit'hat Frashëri.

Koresp. "Urtësia"

"Çdo njeri që mendohet pak e që kujdeset për rrojtjen e këtij vendi të mjerë, dëshiron të shohë të mbështillen e të vihen në rregull makar ato gjëra të paktë që kanë mundur të shpëtojnë nga zjarri e nga armiqësia e njerëzve, të mos lihen në dhëmbët e minjve ose në pikat e lagështirës." Tri dekada më vonë është përsëri ai, që pa marrë parasysh drobitjen që i sjell mërgimi, vë kusht - dhe këtë është mirë ta dëgjojnë të gjithë ata, që pasi e kanë baltosur për shtatë dekada, sot mbajnë në injorancë buzët rrudhur, - vë kusht spastrimin e figurave të kompromentuara me pushtuesit nazifashistë nga çdo ndihmë politike dhe aktivitet kundër regjimit komunist të Tiranës. Mit'hat Frashëri ishte mishërimi i një shërbestari të mëmëdheut sipas kokës së tij.

VLERËSOJMË KONTRIBUTIN TUAJ!

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në takim për çështjet e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në Departamentin Amerikan të Shtetit

Me ftesë të Departamentit Amerikan të Shtetit, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë këto ditë në takim rreth demokracisë, sigurisë, të drejtave të njeriut, si dhe prioriteteve të tjerë në kontekst të zhvillimeve të reja fetare. Një analizë e thellë për situatën e sotme, por edhe qëndrimet e mundshme përballë sfidave, do të përcillnin pothuajse krejt vepërimtarinë, e cila prekte sigurisht ndjeshmërinë globale përballë prirjeve të shumanshme. Rrugët e deritanishme të ndjekura shpesh, u analizuan përmes ideve dhe praktikave për të sotmen dhe të ardhmen, duke synuar zgjidhjen sa më imediate të sfidave të mëdha përmes të cilave kalojnë sot çështjet e demokracisë dhe lirive themelore të njeriut.

Në çeljen e këtij takimi, znj. Patricia Davis, drejtoreshë byroje, solli në vëmendjen e të pranishmëve kujdesin dhe vlerësimin e thellë përmes të cilëve, Departamenti Amerikan i Shtetit përcjell këto shqetësime dhe u ndal sidomos në potencialet intelektualë për kapërcimin e tyre, ndërsa z. Michael Kozak, paraqiti disa përvoja të vlefshme në pikëpamje të ushtrimit të lirisë dhe të drejtave fetare. Në panelin në fjalë, të pranishmit dëgjuan dhe fjalën e Kryegjyshit Botëror Bektashian, në lidhje me këto liri themelore. Ky bëri një ekspozitë të shkurtër të të drejtave në Shqipëri dhe më tej, e shtriu fjalën



e tij, tek objektet e kultit në Maqedoni, posaçërisht në teqenë 'Harabati-Baba' të Tetovës, ku prej vitesh besimtarët bektashianë nuk mund të ushtrojnë lirisht besimin dhe praktikën e tyre tradicionale. Edhe pse Selia e Shenjtë Bektashiane në Tiranë ka bërë publik dhe denoncuar uzurpimin e territorit të teqesë bektashiane prej ekstremistëve islamikë, edhe pse është sensibilizuar opinioni ndërkombëtar përmes selive diplomatike në Shkup, edhe pse Gjykata e Strazburgut ka kërkuar largimin e uzurpatorëve, sërish nga mekanizmat përkatës të shtetit maqedonas ka indiferentizëm.

Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i bëri me dije të pranishmit se besimi bektashian, qysh në fillimet e tij dhe veçanërisht në trojet Ballkanike në shekujt 14 e 15 ka mundur të zgjerohet hap pas hapi dhe të fitojë terrene shpirtërore dhe gjeografikë. Vetëm e vetëm përmes doktrinës paqësore që shpërndante, duke ushqyer paqe dhe vëllazëri midis komuniteteve fetare të ndryshëm, por edhe të etnive

E interesuar për zhvillimet e sotme të Selisë së Shenjtë Bektashiane, Samantha Tu, udhëheqëse e programit për nismat e jetës, dëgjoji nga Kryegjyshi Botëror se në cilat kushte, gati nëntë dekada më parë Qendra Botërore u shpërngul nga Turqia në Tiranë, si dhe përpjekjet e klerikëve bektashianë për të ruajtur me çdo sakrificë gjuhën, vetëdijen kombëtare dhe vetë fatet e kërcënuara të Shqipërisë. Ajo ndau me Kryegjyshin idenë se në të vërtetë, çdo lider fetar nuk përcaktohet nga titujt apo uniformat, por nga dashuria dhe devocioni për Krijuesin dhe fryma e vëllazërisë që shpërndanë ndër besimtarë. Ndërsa Ambar Riaz Zobairi, ministër i feve për Afrikën Veriore, pas bisedës me Kryegjyshin Bektashian, por nisur edhe çfarë të pranishmit shprehën për bektashizmin në këto takime, e mbylli fjalën e vet: “Në botën e sotme fetare nuk ka shumë rëndësi epërsia numerike e besimtarëve. Predispozitat që rregullojnë kushtet e ushtrimit të lirive fetare, janë të prirura të kujdesen deri për komunitete të vegjël numerikisht. Çdo lloj besimi sot merr forcë prej kontributeve që përfaqëson dhe përcjell në të mirë të ndërtimit të modeleve më të mirë të rrethuara prej mirëkuptimit universal mysliman. Në këtë kuadër ne çmojmë lart dhe vlerësojmë kontributet tuaja!”

të ndryshme që erërat e historisë i kishin bashkuar dhe ndarë shumë herë në situata aspak miqësore. Klerikët bektashianë, të djeshmit dhe të sotmit, duke ecur në gjurmët e udhëheqësit të tyre shpirtëror, Haxhi Bektash Veliut, janë përpjekur dhe përpiqen të ngulitin tek milionat e ndjekësve të tyre se dashuria e shenjtë për Krijuesin, nuk mund të pranohet apo identifikohet pa vëllazërinë fetare, atë frymë që mbanë gjallë paqen midis kombeve.

Më tej takimi vijoi me bisedimet e hapura të Charles Blaha, Steve Moody, Anne Benett, Karen Fjeld etj, të cilët folën për të drejtat ndërkombëtare, çështjet e sigurisë njerëzore, të lirisë në internet, deri tek procesi i dorëzimit të propozimeve për marrjen e granteve të ndryshëm që vihen në dispozicion të zgjidhjes së alternativave që dalin. Edhe në këtë pikë, Kryegjyshi Botëror Bektashian dha mendimin e vet, duke u nisur nga fakti që Selia e Shenjtë Bektashiane, pavarësisht bashkëpunimit me vende të tjerë myslimane apo prioriteteve të sotme, përpiqet të kryejë misionin madhor të saj, duke u mbështetur vetëm tek kontributet ekonomike të ndjekësve të saj. Ai tha se mbetemi shumë të kujdesshëm në çdo kërkesë tonën, me idenë e përm-bushjes së objektivave shpirtërore pa u ndikuar në veprimtarinë vetare nga të tjerët.

Gjatë takimit në fjalë, në mjediset e Departamentit Amerikan të Shtetit, Kryegjyshi Botëror Bektashian u takua dhe bisedoi me personalitete të lartë zyrtarë dhe fetarë si, me z. Giovanni Dazzo, Anne Bennett, Kranneth M. Davis, Amy Phiper, Sharon Duong etj. E interesuar për zhvillimet e sotme të Selisë së Shenjtë Bektashiane, Samantha Tu, udhëheqëse e programit për nismat e jetës, dëgjoji nga Kryegjyshi Botëror se në cilat kushte, gati nëntë dekada më parë Qendra Botërore u shpërngul nga Turqia në Tiranë, si dhe përpjekjet e klerikëve bektashianë për të ruajtur me çdo sakrificë gjuhën, vetëdijen kombëtare dhe vetë fatet e kërcënuara të Shqipërisë. Ajo ndau me Kryegjyshin idenë se në të vërtetë, çdo lider fetar nuk përcaktohet nga titujt apo uniformat, por nga dashuria dhe devocioni për Krijuesin dhe fryma e vëllazërisë që shpërndanë ndër besimtarë. Ndërsa Ambar Riaz Zobairi, ministër i feve për Afrikën Veriore, pas bisedës me Kryegjyshin Bektashian, por nisur edhe çfarë të pranishmit shprehën për bektashizmin në këto takime, e mbylli fjalën e vet: “Në botën e sotme fetare nuk ka shumë rëndësi epërsia numerike e besimtarëve. Predispozitat që rregullojnë kushtet e ushtrimit të lirive fetare, janë të prirura të kujdesen deri për komunitete të vegjël numerikisht. Çdo lloj besimi sot merr forcë prej kontributeve që përfaqëson dhe përcjell në të mirë të ndërtimit të modeleve më të mirë të rrethuara prej mirëkuptimit universal mysliman. Në këtë kuadër ne çmojmë lart dhe vlerësojmë kontributet tuaja!”

Koresp. “Urtësia”

DITURIA SI VLERË SUBSTANCIALE E BEKTASHIZMIT

Nga Ejona Picori

Rrjedhat përmes të cilave ka ecur mendimi Islam kanë nxjerrë në pah më së shumti dëshirën dhe veprimin konkret për marrjen e diturisë, për kërkimin në të fshehtat e saj, qoftë edhe me çmime të larta të armiqësisë në karvanët e të paditurve. Për më tepër, nëse sjellim ndër mend memuarët e dijetarëve më të vlershëm myslimanë, gjejmë të provuar se Islami në krejt historinë e vet ka pasur një afinitet të tejdukshëm, një lidhje në aspektet tekstuale dhe ato shpirtërore, midis diturisë dhe besimit, përmendet ndoshta shembujve të tjerë çoroditës të feve të tjera.

Është po kaq e vlershme gjithashtu vendi që doktrina myslimane i ka dhënë diturisë jo vetëm në kontekstin e historisë, por edhe me bashkëveprim me paralelet e tjera të zhvillimit dhe përparimit të saj, brenda vetëdijes religjionare. Një përvijim i tillë konceptual ka mundësuar gërshetimin po se po të diturisë materiale me atë fetare, por edhe i lidh ato në mënyrën më perfekte me frytin e besimit, çka me të drejtë të çon tek kthjelltësia dhe modestia ndaj Zotit të botëve.

A mund të themi sot pas këtyre përvojave shekullore se pa një ndërthurje të këtyre dy diturive, vështirë të arrihet ambicia e mendimit islam: Mendoj se po. Është katërcipërisht e pranuar tanimë se vizionet sekulariste ngërthejnë brenda tyre kërkime apo

instrumente që mund të përparojnë jetën materiale, ndërsa nuk mund ta udhëheqë njeriun drejt kënaqësive të thella shpirtërore sepse është besimi tek krijuesi që mban gjallë shpirtin, mbjell dhe ushqen vlerat, largon atë nga tirania e emocioneve dhe bën që ditu-



Nuk është objekti i këtij studimi të nxjerrë në pah hadithe të shumtë (njëri më i vlefshëm se tjetri) që flasin për diturinë shpirtërore, duke e përcaktuar qartë misionin hyjnor të saj në rrafshin e formësimit të shpirtave njerëzorë. Është pra, qartësisht e kuptueshme pse thuhet shpesh ndër ne, se vendqëndrimi i dijetarëve është kaq i lartë saqë nuk arrihet me jo vetëm me këmbë, por edhe sikur të fluturosh, atje me krahët e zogut. Përmes diturisë fetare, njeriu njeh në thelb, në radhë të parë veten e vet, pastaj Zotin e vet dhe përmes udhëzimeve të tij kërkon të ecë pa gabime në kohë bote kaq kalimtare dhe të përkohshme.

ria e fituar të investohet vetëm në dashuri e paqe. Jeta e përditshme njerëzore meriton një status të veçantë, pikërisht kur motivohet nga shpirti përpara kalkulimeve të ftohta matematikore.

Nuk është objekti i këtij studimi të nxjerrë në pah hadithe të shumtë (njëri më i vlefshëm se tjetri)

që flasin për diturinë shpirtërore, duke e përcaktuar qartë misionin hyjnor të saj në rrafshin e formësimit të shpirtave njerëzorë. Është pra, qartësisht e kuptueshme pse thuhet shpesh ndër ne, se vendqëndrimi i dijetarëve është kaq i lartë saqë nuk arrihet me jo vetëm me këmbë, por edhe sikur të fluturosh, atje me krahët e zogut. Përmes diturisë fetare, njeriu njeh në thelb, në radhë të parë veten e vet, pastaj Zotin e vet dhe përmes udhëzimeve të tij kërkon të ecë pa gabime në kohë bote kaq kalimtare dhe të përkohshme.

Është transmetuar prej Ahmedit, Ebu Davudit, Ibn Hibbani dhe saktësuar prej El-Hakimit, se lidhur me vlerat e dijetarëve shpirtërore, Profeti Muhamed a.s. është shprehur: "Vërtet engjëjt do të zgjasin krahët e tyre për kërkuesin e diturisë në shenjë adhurimi për atë që bën. Vërtetë për dijetarin kërkon falje (të mëkateve) ata që janë në qiell dhe në tokë, madje edhe balena në ujë. Vlera e dijetarit ndaj adhuruesit të besimit është sikur vlera e hënës ndaj yjeve të tjerë. Vërtet dijetarët janë trashëgimtarët e peygamberëve,

vërtet peygamberët nuk kanë lënë trashëgim ndonjë dinarë apo dërrhem, por kanë trashëguar dituri. Ai i cili e merr këtë dituri, sigurisht ka fat të madh".¹⁾

Jo vetëm sipas dispozitave kurane, jo vetëm sipas parimeve tanimë të pranuar prej mijëra dijetarëve myslimanë, jo vetëm sipas logjikës së dymbëdhjetë imamëve por edhe për miliona besimtarë të sotëm, është shumë e kthjellët ideja që dituria e vërtetë konsiderohet si faktor parësor i besimit, madje më të shumtën e rasteve është argument i tij. Përpara se të jetë i varur nga lëkundjet e zemrës, besimi është i varur nga dituria, sepse rrugët e perceptuara për të shpënë tek kjo dituri janë në të vërtetë dyer që hapen ngadalë dhe përmes mundimesh. Askush nga dijetarët apo besimtarët nuk mendon se këto dyer t'i hap dikush për lëmoshë. Përkundrazi sakrificat dhe mundimet më të skajshëm drejt devotshmërisë së përgjeshme ndaj krijuesit janë elemente bazikë të arritjes së dijeve.

Përsa i përket tarikatit bektashian (pashmangërisht ndaj mendimit më të epërm islam në këtë rrafsh) vlerat diturore në të shumtën e rasteve kanë përcaktuar fatet e zhvillimit të tij, duke u kthyer me kohë, në substancën atomike shpirtërore, në vetë ADN e ndjekësve dhe klerikëve. Përgjithësisht, duke vepruar në kohë dhe hapësira të ndryshme, ideja e bektashinjve për diturinë ka qenë e kthjellët. Dijetarët sipas tyre, e kanë origjinën nga uji dhe siç dihet brenda tij nuk mund të gjallojnë gjëra të papastra, sepse origjina e ujit, nuk është gjë tjetër, veçse xhevahiri jeshil. Esenca e këtij xhevahiri merr forcë nga forca e



Allahut dhe nuk ka pse të çuditet askush kur origjina kërkon origjinën nga vjen. Meditimi i këtyre dijetarëve është transmetuar ndofta jo në atë masë por në koncepte fragmentarë sidomos tek klerikët

e djeg. Ky quhet zjarri i dashurisë. Të gjitha këto mrekulli ndonëse të “habitshme” vijnë sa hap e mbyll sytë prej thënies “Lebbejk” nga Allahu dhe thënies së të dashurit të tij: “O Zoti im” ²⁾



bektashinj.

Një qasje interesante rezervon vetë kreu i bektashinjve, Haxhi Bektash Veliu, i cili ndonëse lindi në Horasan (Persi) në shekullin e 13, u vendos në Anadoll, në vendin që quhet sot Haxhibektash dhe që pushoi miliona zemra besimtarësh përmes diturisë dhe urtësisë së tij. Në veprën e tij të titulluar “Makalat” në lidhje me dijetarët shpirtërore, shprehet midis të tjerave se këta nuk mund të japin shpirt deri kur të arrijnë të plotësojnë detyrat e tyre. Është sikur të godasësh një hekur të fortë në tokë. Brenda tij del tym, i cili ngjitet në qiell, ndërsa zjarri mbetet në oxhak. Kjo pra, që quhet trëndafili i Rejhanit është lulja e dashurisë. Ndërsa vetë dashuria është zjarri i ekzistencës së Allahut. Ja pra, dashuria i jep lëvizje shpirtit dhe

Brenda shtjellave të dijes shpirtërore, (sidomos nga hulumtimet e mia për tarikatin bektashian) vërej se kjo pasur nuk ka shërbyer si stoli, për ata që e patën tretur në idetë e tyre dhe për krenari aspak dinjitoze ndaj atyre që nuk mund t’i nxinin njohuritë me fjalë. Sidomos dijetarët bektashianë, nëse i kundron përmes një vështrimi analitik, duket se mbajnë një qëndrim të përkorë ndaj bashkëbiseduesve jo të nivelit të tyre, madje në shumë raste sillen sikur të mos e vënë re fare këtë disproporcion intelektual. Në fakt ata nuk mund të hidhnin hapa, veçse në rrugën e treguar nga Imam Aliu a.s, ky dijetar që ka punuar gjithë jetën në dritën e realiteteve të shpallura përmes profetësisë: “E drejtë e dijetarit është të mos shprehësh

kryeneçësi ndaj bisedës, të mos e nxjerrësh në shesh të fshehtën e nivelit të ulët të bashkëfolësit, të pranosh edhe falje kur vetë ai ta kërkon diçka të tillë. Nga dijetari kërkohet të respektosh bashkëfolësin për hir të Allahut, përdërisa vetë ai e ruan atë që ka urdhëruar Allahu. Mos ia kthe shpinën atij, të vobektit në shpirt” ³⁾

Ngjashmëri të ardhura jo vetëm prej traditës myslimane, por edhe përmes bashkëveprimit të sferave të etikës dhe dijes, nxjerrim në pah një anë të pandriçuar sa duhet, në marrëdhëniet midis myrshidit dhe myridit në bektashizëm. Tradita bektashiane ka paracaktuar qysh në gjenezë të saj se i dashuruari dhe dashuruesi janë kurdoherë së bashku dhe s’ka fuqi tokësore të ndajë. Shpesh u blatohet togfjalëshi “si shpirti me trupin” që nuk kanë frymë pa njëri – tjetrin, sepse qëllimi më i afërm i dashurisë është të arrijë tek i dashuri derisa të arrihet në njëshmërinë sakrale. Ajo gjallëri e përjetshme, ajo hapësirë gati kozmike që nuk e nxinte deri më sot as bota e tërë, as dheu dhe as qielli, u ul dhembshurisht dhe zuri vend në zemrën e dashuruesit të tij. Por tamam për këtë situatë, shekuj më parë Aka Muhamed Ridai shkruante:

Mos u nis në udhë pa pasur myrshidin

Ka errësirë dhe mund të humbësh... ⁴⁾

Në fillimet e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, sipas dokumenteve osmane, në krye të tarikati bektashi erdhi Ballëm Sulltani, për të cilin në të vërtetë ekzistojnë disa gojëdhëna për mënyrën se si e pa dritën e diellit. E rëndësishme është se në esencë, ky besim nisi të organizohej i ndërthurur me elementë të rinj, të vështirë në pamje

të parë, por që ia dolën mbanë të prireshin drejt një udhëheqësi të madh, të përbotshëm, me ndihmën e pakursyer të myshidit të tyre. Pavarësisht se cili ishte shkaku i mundshëm, ngjashëm edhe me besime të tjerë paraardhës, Ballëm Sulltani me mendjen e hapur të tij, bëri diferencimin e klerikëve bektashinj në të martuar, ose jo të tillë, madje një ceremonial i tillë ka ardhur në shëmbëllimin real më të përkryer të tij deri në ditët e sotme.

I përkrahur edhe nga regjimi otoman i kohës (po të kemi parasysh se Sulltan Bajazidi i Dytë adhuronte këtë tarikat) Ballëm Sulltani e pati kuptuar se çdo lloj organizmi fetar, kalonte përmes reformash diturore dhe për këtë vlente që teqetë bektashiane të kishin mundësi edukimi dhe përparimi për kontingjentet e klerikëve rishtarë. Janë dhjetëra dokumente që provojnë se udhëheqësi i dytë bektashian (siç e thërrasin ende sot) e kthen teqenë e njohur në krejt Rumelinë, të Sejid Ali Sulltanit, në Dimotekë, në një shkollë me parimet më të shëndosha për marrjen e diturive shpirtërore, duke sintetizuar në mënyrën më të tejdukshme mësimin e Profetit Muhamed a.s: O njerëz, lexoni sepse ditura arrihet duke studiuar dhe njohja arrihet përmes të kuptuarit. Atij që Allahu i dëshiron të mirën e nxit të mësojë në punët e fesë.⁵⁾

Bazat teorike dhe doktrinarë të hedhura në teqen bektashiane të Dimotekes, kanë patur ndikimin e tyre të madh në traditën gjalluese me domethënie thelbësore jo vetëm për këtë tarikat por edhe për vetë Islamin. Vizioni gjithëpërfshirës me të cilin Ballëm Sulltani e

pa bektashizmin dhe në mënyrën më të veçantë këmbëngulja për marrjen e diturisë nga udhëheqësi shpirtëror të tarikatit, bënë që ky pasardhës i denjë i Haxhi Bektash Veliut, të zinte vendin e tij në Qendrën Botërore Bektashiane, në Azinë e asaj kohe.⁶⁾ Shekujt që erdhën më pas vërtetuan se atmosfera e krijuar nga veprimtaria shumëplanëshe e teqesë së Dimotekës, ishte një rrugë e çelur për dituri të gjera.

Nuk është shumë e vështirë të kuptosh se qysh në lindje të tij, Islami kërkon që dituritë shpirtërore dhe ato të fushave të tjera të mund të plotësojnë njëra – tjetrën përmes përpjekjeve për të bërë njeriun sa më të lumtur. Nuk ka se si të jetë e rastësishme që Kur'ani në ajetin e parë të tij shpall: "Lexo në emër të Zotit tënd, i cili krijoi gjithçka!"⁷⁾ Nënshkrimi i urdhrit të parë hyjnor me një insistim të tillë ogurmire, dëshmohej si argumenti më i qartë për pozitën e diturisë në kontekstin mysliman. Dhe ky fakt na çon çiltazi tek realitetet ku shkallët e para të mësimin të diturive ishin në oborret e xhamive dhe teqeve.



Këtu e shoh me vend të ndalem pak më konkretisht, pasi edhe lënda që lidhet me qëndrimin e tarikatit bektashian ndaj diturisë është mbresëlënëse. Në kushtet kur vetëdija jonë kombëtare kishte çelur sythat e parë, ishin klerikët bektashinj që morën përsipër misionin e vështirë, plot brenga e sakrifikime për t'iu transmetuar brezave diturinë shpirtërore, bashkë me historinë e trazuar të kombit. Ndër nismëtarët përmendim baba Fejz Bulqizën, i cili çeli shkallën e parë shqipe rreth vitit 1874, për të sjellë dritën e diturisë jo vetëm në Bulqizë por deri në fshatrat e Dibrës.

Më pas, ndofta tetë apo nëntë vjet, ishte baba Hysen Kukeli, në krye të klerikëve të teqesë që ngriti Shememi – Babai, i cili gjithashtu në luftë të hapur me administratën otomane të Krutës, çeli klasën e parë të këndimit të gjuhës shqipe, natyrisht me germa arabe, i ndjekur nga baba Alush Frashëri, i cili përveç meritës së jashtëzakonshme për çeljen e shkollës Frashër, pati edhe guximin të mbështesë në çdo nivel veprimtarinë e vëllezërve Frashëri.

Për vetë kohën në të cilën po kërkoheshin dituritë shpirtërore dhe ato për kombin tonë, klerikët bektashianë shpesh herë detyroheshin të linin teqetë e tyre (për mos u djegur nga hordhitë otomane) dhe në ilegalitet por të përkrahur nga populli ndërmerrnin udhëtime për marrjen e librave në gjuhën shqipe si edhe shpjegimin, apo përcjelljen e tyre, në shtëpi ku nxënësit mblidheshin në grupe për të "thithur" dijet e Zotit, historisë dhe bëmat e të parëve të tyre.

Shembulli më sintetizues i këtyre klerikëve mbetet ndofta baba Meleq Shëmbëdhënji, i cili ndonëse mori kulturë të lartë fetare dhe mistike në teqenë e baba Abazit në Egjipt, erdhi në Shqipëri në vitin 1879 dhe nisi veprimtarinë e shenjtë atdhetare. Dhuntia e tij e shkëlqyer për të ndërthurrur dijenitë e shpirtit me të tjera, bëri që të kërkohet me ngulm së bashku

me atdhetarë të tjerë shqiptarë të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë. Në rrethana të tilla ai përndiqet nga otomanët dhe shkon në viset shqiptare në Manastir ku vazhdon aktivitetin, për të vijuar më tutje trimërisht në lagjen shqiptare të Merdivenkojt në Stamboll, ndërsa në vitet 1904 – 1906 e shohim në Bukuresht, në koloninë e atjeshme të shqiptareve.⁸⁾

Qartazi në këtë fond të arkivit shtetëror përmes një dokumentacioni të plotë bëhet fjalë edhe për veprimtarinë e shquar në rang të shkollave dhe mësimin të gjuhës shqipe edhe për personalitet të tjerë të vlershëm si: baba Ahment Koshtani, baba Sali Metohasanaj, baba Selim Gjirokastra, baba Hysen Melçani, baba Hajdar Turani, baba Zejnet Kaloshi, baba Xhafer Prishtë etj. Në zemër të ideve dhe kontributit të shkëlqyer të këtyre klerikëve qëndronte vlerësimi se,

ekzistenca e një kombi përveç të tjerave është ekzistencë e një simbioze midis diturive hyjnore dhe atyre atdhetare. Ka gjithashtu një lidhje të dukshme (nëse i referohesh filozofisë çliruese të bektashizmit) të dëshirës për të transmetuar dije shpirtërore tek nxënësit, por duke i përgatitur këta më parë përmes parimeve të strukturës së brishtë të tarikatis.

Rishmëz duke sjellë një pasazh nga ligjërimet e Profetit a.s. mësojmë se: udhëzimi dhe dijenia ime të cilat Allahu mi ka udhëzuar janë si shiu që bie në tokë. Toka pjellore e pranon ujin dhe prodhon barin dhe kullotat, ndërsa toka jopjellore e mban për vete ujin, prandaj Allahu bën që uji të shfrytëzohet për t'u pirë, për bagëtinë, për mbjellje. Shiu bie edhe në vende të tjera nëpër shkretëtira, të cilat nuk e mbajnë dot ujin e nuk prodhojnë kurrfarë bimësie. Ky është shem-



bulli për atë që ka njohur ligjet e Allahut dhe ndjek Kur'ani që më ka dërguar Zoti mua. Prandaj mëso për vete, mëso edhe të tjerët”⁹⁾.

Më shumë se sa një sanksion statusor personalisht kam besuar se mund të jetë tipar zakonor, fakti që në teqetë bektashiane dashamirësit apo të dashuruarit me këtë tarikat shkojnë tek ky objekt kulti krejt të çlirët dhe edukimi nga kleriku e perceptojnë kurdoherë si edukim nga mësuesi i klasës së parë, kur bota përpara hapet plot të papritura dhe ja vlen të kesh dikë të mbaj përdore, për të qenë i sigurtë në udhëtim, ashtu si mësuesi i klasës së parë edhe klerikët bektashianë mbjellin dashuri midis ndjekësve të tarikatit edukojnë që këta jo vetëm ta duan por edhe ta ndihmojnë njëri tjetrin, t'i përulën njëri – tjetrit në veprat e mira që shohin dhe të mbajnë qëndrim sa më të rreptë për çdo ligësi të shfaqur, gjithmonë duke ruajtur vëllazërinë. Pikërisht këtë arsye mendoj se me lehtësi në tarikatën bektashiane, zënë vendin e tyre të merituar fjalët “Prind dhe prindëri” (që do të thotë respektivisht dervish dhe teqe e vogël).

Për t'i mbyllur këto shënime e shoh me vend të përsëris atë çka mijëra dijetarë kanë thënë përpara meje që feja islame e ka vlerësuar në shkallën më të epërme kërkimin në dituri, përqaftimin e ideve që nxisin përparimin, tolerancën dhe respektin e thellë për atë që ke në krah. Rituale të njohura, ato që quhen “farz-e domosdoshme” shihen dhe vlerësohen kurdoherë në spektrin logjik dhe hyjnor maksimalisht të duhura, përmes universit të diturisë. Në ndonjë mendja të këtyre kohërave kam parë e dëgjuar (jo pa një ndjenjë keqardhjeje) se bektashinjtë nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur lutjeve dhe adhurimeve, pretendim i cili mëton se zbulon diçka të re në vulgaritetet shqiptare. Dituria e shpërndarë prej shekujsh nga klerikët bektashianë, sigurisht i tejkalon këto mëmërima që vijnë prej moskuptimit të substancës së diturisë.

Do tu kujtoja këtyre kritizimeve të paskrupullt se një studiues i njohur anglez, i cili gjatë vizitës që ka bërë në vitin 1933 në Selinë e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, duke biseduar me të famshmin Sali Njazi Dede, i cili vite më pas ra dëshmor i



atdheut, ka shkruar shumë vëmendshëm se: opinionimi i përgjithshëm është se bektashinjtë e neglizhojnë tërësisht veprimtarinë fetare që kërkon sheriati. Por në të vërtetë bektashinjtë i respektojnë ligjet e tij. Në mbrëmje, ndërsa rrija në dhomën e pritjes të Sali Njazi Dede, pashë nga dritarja një dervish që ecte nëpër verandë dhe thoshte lutjen e mbrëmjes.¹⁰⁾

Burime

1. Dr. Isuf al-Kardavi: *Pejgamberi a.s dhe dituria – shtëpia botuese “Furkan” – Shkup 2004.*
2. Haxhi Bektash Veli: *Makalat, Ankara 2016, fq. 75*
3. Xhamia Bejan el-Ilm: *Udhëtim për diturinë, vëllimi i parë, fq. 157*
4. Seyyed Hossein Nasr: *Philosophy in the land of Prophecy, New York – Pres 2006*
5. “El-Fet’h” Vëllimi i parë fq. 170, transmetuar nga El-Fatidhi
6. Gazeta “Turk Yundu” nr.28, Nisan 1927
7. El-Alek: I
8. Arshivi Qendror i Shtetit, fondi viti 1937, dosja 50
9. “El-Tergib” transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi
10. John Kingsley Birge: *Urdhri i dervishëve bektashi, botim i parë në Britani, viti 1937. Botimi i dytë shqip në Tiranë, fq. 129, v.2007.*

Poezi

nga Ferit Fixha

Bektashiu

I falet Zotit sa hap sytë,
Që sa vjen në këtë jetë,
Siç mëson Abaz Aliu,
Bektashiu ndrit përmbi dhe,
I pastër si fllad veriu.

Në udhë të Bektash Veliut,
Në shembull të Abaz Aliut,
Bektashiu pa të metë,
Besimtar në admirim.
Ecën rrugës së vërtetë.

Sipas thënies lapidare,
“Pa atdhe, nuk ka fe!”
Për besim e çështje amtare
I kën i lumtur e mbyll sy,
Si dëshmor para tij.

Porosi e Naim Frashërit

Porosit Naimi me emër,
Poeti i madh bektashi:
“Të punojmë ditë e antë,
Me durim e urtësi!”

Dashuri, vëllazëri,
Që të venë punët të mbarë,
Të mos shahet shqiptaria,
Për qytetërim kombëtar.

Të besojmë perëndinë,
Shembull Abaz Alinë,
Hatixhenë, Fatimenë,
Në Kombin dhe Atdhenë.

Të duam Hasan, Hysen,
Të duam gjithë njerëzinë,
Gjuhën tonë, Mëmëdhenë,
Të largojmë marrëzinë...”

Poetëve bektashinj

Mjeshtërisht ju thurët vargje,
Në epikë dhe lirikë,
Latë pasuri të madhe,
Një thesar për ne të gjithë.

Mesazhet në ‘to gëlojnë,
Si rubin vezullojnë dijet,
Dhe shpirtin na e ndriçojnë,
Na i zbojnë veset, hijet.

Bëtë poezi hyjnore,
Që na ngrohin pors dielli,
Sepse universi juaj shpirtëror,
Është i kthjellët si qielli.

Ata çojnë drejt së mirës,
Së vërtetës, drejtësisë,
Drejt dritës, larg territ,
Në shërbim të njerëzisë.

Shkrove ti Edit' h Durham

Për mistikën ndër shqiptarë,
Tolerancën, panteizmin,
Shkrove ti Edit' h Durham,
Me respekt për bektashizmin.

Se kjo dritë nuk qe shuar,
Prej saj t' u ndez fantazia,
“Mbanë aromë t' Omer Kajamit”,
The ti mike nga Anglia.

Diku hyrë dhe në tyrbe,
Rrugës kur shkove n'Përmet,
Drejt vendlindjes së Naimit,
Bektashi, poet i shenjët.

Të mikpritën Zonjë e madhe,
Të nderuan s'ka më mirë,
Të bekuan "Mos paç halle!",
Gjithë klerikët, me dëshirë.

nga Hyqmet Hasko

Njeri i mirë bektashi.

Nëpër kohëra Zoti krijoj fetë,
ja pershtati të gjithë njerëzisë
në bash të vendit përherë u gëjë,
Imam Aliu i Bektashisë.

Predikoi përherë shpirtbardhësinë,
i shtriu krahët gjer tek ne;
fjalë e mençur me fisnikërinë
dashurinë për atdhe dhe fe.

Të gjitha fetë janë mbështetur
Veç tek sytë e gjithësisë;
shkrumboj çdo fjalë përdredhur
bekojnë qumështin e mëmësisë.

Sa vjen, dëbon vetminë e plogët
dhe ndez zjarrin e dashurisë;
Bektashizmi bashkoj kohët,
ngriti statujen e perëndisë.

Nëpër kohëra u ndezën zjarre
u orientua i gjithë njerëzimi
u ngrit dhe shoqti vullkane
me fjale mirësie bektashizmi...

Ne çdo gjuhë të çdo kombi,
është një fjalë me plot liri,
i bekuar përherë nga zoti,
Njeriu i mirë bektashi.

Bektashi ish Samiu, dhe Naimi,
Shqiptarinë e mbartën si bekim,
Nga buzët e të ëmblës gjuhë premtimi,
Endet nga dje e sot gjer në amshëim.

Mal me emër Zoti.

Gjithmonë kam menduar,
të kisha çelsin të hapja zemrën tënde,
Tomorr me madhësitinë e zotit bekuar,
shkëlqimi yt ka pushtuar çdo mendje.

Çdo vit mbushesh me pelegrinazhë,
të gjithë të duan, të gjithë të prekin,
madhështia jote kapërcen çdo imazh
mal me emër bektashiu veç ti e ke çelsin

Tomorr veç ti e ke çelsin e perëndisë,
me fjalë majëkrahur flet me zotin,
kur vijmë tek ti na flet me fjalën e mençurisë
gjigand si vetja e bën robin.

Kam urdhur përherë tek ti me besimin e zotit,
kam folur për të mirat, dhe për hallet e mia,
me ke thënë se nuk e ke çelsin e shenjtorit,
Çelsin e perëndisë e ka vetëm bektashia.

Tomorr je mali që di të gjitha gjuhët,
Por ti flet përherë me gjuhën e njerëzimit,
emri yt i bekuar kurrë nuk shuhet,
ti ke çelsin fisnik të Bektashizmit.

Dhe kur largohem marr me vete,
krenarinë dhe madhësitinë tënde,
o mal me emër zoti që tund djepe,
ti ke çelsin e magjishëm të çdo mendje.

Tomorr ku bubullon e vetetin dhe në verë,
në gjirin tënd vijnë prehen besimtarët,
me kurë dashurie të shëruar gjithëherë,
se veç për dashuri sot kanë nevojë shqiptarët.

Ai që do njerëzinë

Feridon Metko – SHBA

Të lindur e të rritur me frymë bektashiane, nr filloristet e dikurshëm, kemi pasur përzemër në mënyrë të veçantë kryebektashiun Naim Frashëri. Unë vetë, sot e kësaj dite, i kam të ngulitura fort në kujtesë, vargjet që m'i mësonte gjyshi dhe që bënin fjalë për Qerbelanë.

Çuditërisht, emri i Qerbelasë ish rrënjësor aq thellë në imagjinatën tonë fëmijnore, sa që dinim me hollësi shkretëtirën, hurmat, lumin e Eufratit dhe nuk dinim asgjë për fushën e Korçës. Im gjysh me mësonte vargje përmendësh dhe nuk harronte të më porosiste që mos t'i thoshja ato vargje në shkollë se ishin të ndaluar.



Naim bej Frashëri natyrisht që studiohej në tekstat tona shkollore, por libri "Qerbelasë" ishte i ndaluar sepse ishte me përmbajtje fetare. Prandaj ne mësonim fshehtas dhe po kështu fshehtas recitonim:

Ai që do njerëzinë,
Beson Muhamed Alinë,
Hatixhen e Fatimenë,
Dhe Hasan edhe Hysenë...
Prandaj mendojnë ta mbledhim
Dhe ligësitë t'i hedhim
E të zemë mirësitë
Që na nxjerrënë në dritë.

Së pari, kur erdha në Detroit dhe shkova në teqenë bektashiane të baba Rexhebit, takova nxënësin shpirtëror të tij, baba Arshi Bazai. Ai më priti krahëhapur siç dinë të presin vetëm baballarët e teqeve dhe kur i thashë se isha nga Kolonja, sikur u çel në fytyrë. Po më tej kur më pyeti për tim gjysh dhe i thashë se ka qënë në çetën nacionaliste të Safet Butkës, u përplot. E kish njohur e takuar Safetin. Me siguri u përplot për dramën që përcolli jetën e tij. Pastaj më tha t'i bënim një vizitë baba Rexhebit dhe unë e kuptova se duhej të shkonim në tyrben e ngritur në nder të veprës madhore të atij shenjtori.

U ngritëm, u veshëm dhe dualëm në oborr. Ishte shumë ftohtë dhe bora kish mbuluar krejt sheshin e madh përpara teqesë. Baba Arshiu, në vend të shkopit mori një lopatë në dorë dhe nisi të qërojë borën nëpër shtegun që të çonte në tyrbe. M'u dhimbs kur e kuptova se çfarë mundimi hiqte, prandaj doja t'i merrja lopatën nga duart. Ai jo vetëm nuk e lëshoi kopatën, por befas sytë i shkrepëtinë dhe kuptova se po zemërohej. Më vonë mora vesh se në ditët me borë, baba Arshiu zgjohej herët në mëngjes dhe të parën gjë që bënte, çelte shtegun që të çonte në tyrben e baba Rexhebit. Shenjtori i madh, vizitohej çdo ditë nga myhibë e dashamirës të tij, prandaj duhej

të mbahej rruga e çelur.

Kur babai mbaroi duanë e tij, pashë të përkëdhelte mendafshin e mezarit, njëloj sikur përkëdhelte ndonjë fëmijë. Pastaj diçka pëshpëriti dhe me mori mua pranë vehtes. E kuptova se po lutej tek myrshidi i tij, për jetën time të sapofilluar në Amerikë. Ndjeva frymën e ngrohtë të tij, përmes fjalëve të Imam Aliut. Ne besojmë në Zot, si ai që i var shpresa me bindje vetëm në Zot! Ne besojmë në Zot si ai që dorëzohet në madhësinë, dinjitetin dhe mëshirën hyjnore. Zoti i Lartë nuk ka lindur nga një at që ndokush t'i bëhet pjestar në lavdi, as ka lindur dikë që të trashëgohet. Tek Ai nuk ndodh as rritje dhe as mplakje. Ai na është shfaqur aq sa njohim, duke bërë të dukshëm për sytë tanë, modelin e përkryer të gjithësisë dhe kontrollin e Tij mbi të. Mes provave të krijimit të tij, është padyshim ndërtimi i qiejve, që janë mbërthyer tek njeri-tjetri pa litarë dhe qëndrojnë të varur pa asnjë mbështetje. Ashtu bëri hyqëm.

Ai dhe ata u përgjigjën të bindur me përlulësi dhe pa meri e përtim. Ai ka bërë yjet në qiej si shenja, me të cilat gjejnë orientim udhëtarët që lëvizin udhëve të ndryshme të gjithësisë. Mugëtira e perdece të errëta të hapësirës, nuk e largon dot ndriçimin e dritës së tyre, ose vllot e netëve të zeza s'kanë fuqi ta zbehin dhe ta fikin dritën e hënës kur përhapet në qiej. Lëvduar qoftë Zoti, të cilit nuk i fshihen dot as nxirrosja e muzgut, as nata sterrë e verbër, as shungëllimat e shtrengatave, as shkrepëtimat e rrufesë dhe as rrokullimat e

gjetheve që fluturojnë nga vendi, ku i kanë hedhur errërat e stuhitë apo rrebeshet që derdh qielli. Lëvduar qoftë Zoti, që ka egzistuar qysh përpara ardhjes në këtë botë, të kohës, fronit, qiellit, dheut, xhindeve dhe qenieve njerëzore. Ai nuk mund të përceptohet nga imagjinata, as të çmohet nga të kuptuarit.

Duke ngrënë drekë në teqe, duke parë se si i drejtoheshin baba Arshiut të mëdhenj dhe të vegjël, duke dëgjuar historitë e motshme të babait me dervishë e baballarë që mbajtën gjallë atdhetarinë, sig-

**Vetëm nëse do
njerëzinë, do të mund të
kuptosh se familja jote, nuk është
vetëm, ajo që të jep is dhuratë nëna
e babai. Por familja jote është shumë e
madhe, shumë njerëzore, shumë brenda
shpirtit tënd, si dhuratë e Zotit. Të paktën
ky është një nga mësimet që unë kam
marrë në teqen e baba Rexhepit,
prej të mrekullueshmit baba
Arshiu.**

urisht m'u kujtuan vargjet e Naimit. Duhet të duash Muhamedin dhe Aliun, duhet t'u falesh atyre me përlulje, duhet t'i ndjekësh ata në çdo ditë të jetës tënde, që të mund të vlerësosh dhe të duash njerëzinë. Dhe vetëm nëse do njerëzinë, do të mund të kuptosh se familja jote, nuk është vetëm, ajo që të jep is dhuratë nëna e babai. Por familja jote është shumë e madhe, shumë njerëzore, shumë brenda shpirtit tënd, si dhuratë e Zotit. Të

paktën ky është një nga mësimet që unë kam marrë në teqen e baba Rexhepit, prej të mrekullueshmit baba Arshiu.

Dy vjet më parë, gjeta kohë dhe vajta që të diel në mëngjes. Më thanë se ka njerëz brenda dhe meqë koha ish e bukur u ula në stolat e oborrit, përkundruall derës së madhe të teqesë. Nuk vonoi shumë dhe baba Arshiu u dha tek dera. Më pa tek rrinja mes luleve dhe barit dhe pëshpëriti diçka të tillë: "Eh biro, atje ku ke lerë ti, është xhenet. Këtu të mbyty asfalti". Unë u çova i puttha duart dhe nisëm të shëtisim. E pashë nga sytë se ishte shumë mirë. Ia

mora me një zë të lehtë, se e dija se i qante shpirti për këngët vlonjate: "Dil o lumi i Vlorës —o, dil se do të dalim-o" Më pas në sy dhe kur pikasi se unë isha serioz më erdhi pas me atë zërin e lodhur, por të butësi si mendafshi. Pastaj heshti. Me siguri kënga e kish shpurë shumë larg, në Vlorë, në ato vise që i ka lënë prej gjashtëdhjetë vitesh dhe që kurrë nuk i pa.

Ndërsa ishim duke ecur me kapi nga krahu dhe befaz m'u drejtua: "Sa vjeç mbushe ti Feridon? Unë ula kokën. E kuptova pse më pyeste. Ai e dinte seisha ende beqar dhe donte të hapte muhabetin lidhur me jetën time. Por unë heshta dhe ai nuk këmbënguli. Pastaj kur u ulëm sërish në stolat e drunjtë të oborrit, më tha se duhej patjetër të gjeja një vajzë dhe të martohesha. Se Amerika është e mirë, po nëse nuk martohesh, nëse nuk krijon familje dhe të kesh fëmijë,

Amerika të gërryen brenda. Ehu sa burra të shquar kanë ardhur këtu dhe ata që nuk patën gra e fëmijë mbetën qyqarë. Se fëmija të mban gjallë sa je në këtë botë, por nesër të vjen edhe tek varri dhe të thotë dy fjalë, s'të humbet as varri. Dhe gjithë këtë bisedë e mbylli me merakun: "Ama në më dëgjofsh mua, shiko për ndonjë mall vendi". Unë e putha me shpirt duke qeshur. Me "mall vendi" e kuptova se ishte mirë që gruaja e ardhshme të ishte shqiptare. I kërkova së fundmi të këndonte një dua për mua dhe u largova.



Pastaj erdhën lajme të mira. Në jetën time po hynte me drojtje një vajzë e urtë, me dëshirën e një familjeje të sinqertë me prindër që kishin besuar e besonin në Zot. Kur e solla këtu në Detroit, Zahiden, e para gjë që më shkoi ndërmend ish dua ja që kish bërë baba Arshiu, atë ditë që patëm biseduar për martesën.

Pastaj mendova se në tërë këta vite të punës sime në Amerikë, pamvarësisht vështirësive, halleve apo brengave, unë e kam njerëzinë me sytë e dashurisë, ashtu siç jemi mësuar të shohim brenda familjes tonë fizike. Dhe ndoshta ky mund të ishte një shpërblim i Zotit për ne që besojmë, për ne që jetojmë me djer-sën tonë, me ndershmërinë tonë, duke patur si shem-

buj të mrekullueshëm pikërisht klerikët bektashianë, këta që mbajnë të ndezur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo vetëm qiririn e Haxhi Bektash Veliut por edhe mësimet e vyera të Naim Frashërit.

Natyrisht nuk mund ta harroj ditën kur së bashku me Zahiden dhe djalin tonë të sapolindur shkuam në teqe. U mendova gjatë nëse me duhej të shkoja së pari në tyrbe tek baba Rexhebi e pastaj tek baba Arshiu. Vendosa të takohesha së pari me baba Arshiu dhe ky të vendoste çdo bënim. Ish e diel e bukur dhe ndër kohë që gjithmonë nga shtëpia në teqe doja rreth dyzet minuta, atë ditë shkova atje për më pak se tridhjetë minuta. Diçka më shtynte tok me makinën. Baba Arshiu u lumturua kur na pa me karrocën e djalit tek pragu i derës. E mori djalin në gjoks, i puthi kokën dhe si duke pëshpëritur i këndoi duanë që këndohet në raste të tilla. Asgjë më të bukur s'kam dëgjuar në jetën time se sa ato fjalë të çuditshme që dilnin prej buzëve të tij dhe iknin shumë larg. Pastaj baba Arshiu pa sytë e djalit plot kureshtje. Pa nxitimthi sytë e Zahidesë, pastaj sytë e mij dhe i doli nga shpirti: "Eh mor eh, ky është tamam mall vendi! U rriç me nënë e me babë!"

Larg gurëve e drurëve ku jemi rritur, larg prindërve, vëllezërve dhe motrave, sikundër unë, me qindra e mijra bektashinj, kemi gjetur në teqen e baba Rexhebit, follenë tonë, kemi marrë prej andej dëshira e shpresa, jemi edukuar me dashurinë për njerëzinë. Falë baba Arshi Bazait, ne brezi i besimtarëve të sotëm, po jetojmë në një copëz Shqipërie, këtu në vendin e bekuar dhe që quhet Amerikë. Të falemi në gjunjë dhe të puthim duart babai ynë. Lavdia dhe falenderimi i perkasin Zotit të botëve. Paqja qoftë mbi krijesën më të mirë që Ai krijoi, Muhamedin si edhe mbi gjithë njerëzit e tij. Përshëndetjet dhe paqja qofshin mbi zotërinë e njerëzimit dhe të botës, që shkëlqen si katërmbëdhjeta e çdo muaji e që ndodhet në pozitën më të lartë, që është më i madhi dhe më i lartë i krejt gjithësisë, që në ditën e kiametit do të jetë më i dliurë nga të dliurët. Do të jetë hëna e plotë që shkëlqen në kupën e qiellit, kreu e prijësi më i nderuar i të gjitha qenieve të krijuara, ngazëllimi i botëve, më i miri i njerëzimit dhe i fundmi pejgamber përmbushës i kohës, i dliurësuar, i zgjedhuri Muhamed. Paqja e Allahut qoftë mbi të, mbi familjen e tij, mbi ata që vijnë prej sojit të tij, mbi myrshidët tanë që sjellin vetëm udhëzim e shpresë dhe mbi ne që kemi zgjedhur këtë rrugë!

Teqet si oaze qytetërimi

Nga Roberto Moroco dela Roka - Itali

Bektashinjtë përbëjnë urdhrin islamik heterodoks që është përhapur më shumë në vendet ballkanike nën perandorinë osmane. Shqipëria historikisht është atdheu i dytë i tyre, pas rajonit të Anadollit. Më 1925 selia qendrore e bektashizmit botëror u çvendos madje në Tiranë, pas mbylljes së urdhërave të dervishëve të dekretuar në Turqi nga Ataturku. Është vështirë të vlerësohet me saktësi numri i bektashinjve në Shqipëri midis dy luftërave botërore, edhe sepse autoritetet zyrtare të Islamit sunit i kanë kundërshtuar gjithnjë regjistrimet zyrtare të bektashizmit. Shifrat ndryshojnë shumë sipas burimeve të ndryshme, duke u luhatur midis dy skajeve - prej 50.000 dhe 250.000. Më 1933 Sali Niazi Dedei, kryetari i bektashinjve, i deklaroi studiuesit dhe misionarit Birge, autor i hulumtimit të parë të gjerë të kryer nga një perëndimor për bektashinjtë, se numri i tyre në Shqipëri ishte 200.000, ndërsa në periudhën e fundit të perandorisë së Stambollit ata ishin gjithsej 7.500.000. Historianë bektashinj shqiptarë, në një shkrim të vitit 1929, thonin se fuqia numerike e urdhrin në Shqipëri, e vërtetuar në bazë të statistikave të brendshme të mbajtur deri më 1826 (viti i shkatërrimit të jeniçerëve dhe i krizës së bektashizmit që lidhet me të) ishte, në fillim të shekullit XIX 100.000 veta, domethënë një pjesë e mirë e popullsisë shqiptare të asaj kohe.

Teqetë ku jetonin anëtarët e urdhrin që kishin një farë shkallë njohjeje, rreth vitit 1930 duket se ishin 43, ndërsa pak vite më vonë nja pesëdhjetë. Rreth teqeve ku jetohej në mënyrë murgërore kishin shumë



simpatizantë dhe "ashikë" ("njerëz që dashurojnë"), të cilët ishin të lidhur me urdhrin pa qenë formalisht anëtarë të detyruar të përshkonin të gjitha etapat e lartësimit mistik dhe shpirtëror.

Teqete bektashinjve dukeshin në sytë e udhëtarëve perëndimorë që kanë lënë shumë përshkrime, si oaze qytetërimi dhe pastërtie, në kontrast të madh me botën përreth. Brenda nuk mungonin piktura fetare edhe me figura njerëzore, me gjithë besimin kuranik të bëra pa stolisje të



tepërta, me një shije naif. Teqetë, në vende të veçuara dhe të zgjedhura mirë, ishin në mes të një natyre të mirëmbajtur. Pjesë e kulturës së bektashinjve ishte vëmendja për veçantitë materiale, dashuria për një natyrë të rregulluar dhe për kopshtet.

Bektashizmi si edhe urdhrat e tjerë më të vegjël të Islamit i përgjigjej në thelb kërkesës për një përvojë fetare jo formaliste, ku të mos kishte, për ta thënë skematikisht shkëputje të paskajshme ndërmjet njeriut dhe Perëndisë së dogmës sunite. Ishte kërkesa për një rrugë mistike, për një besim “të ngrohtë”, të përbërë nga faltore dhe nga kulti i shenjtorëve. Ndërsa Islami ortodoks linte pasdore atë që me një term perëndimor mund të përkufizohej si “kujdes baritor”. Bektashinjte ishin të kujdesshëm

për t’u paraqitur si njerëz me një referencë shpirtërore në rast nevoje. Disa nga porositë themelore edhe më pak formaliste të Islamit, si dhënia strehim dhe mikpritja, zbatoheshin nga bektashinjte me skrupulozitetin më të madh: teqetë e tyre ngriheshin në një largësi prej gjashtë orë rrugë njëra nga tjetra, kështu që mund të udhëtohej duke gjetur gjithmonë një teqe ku mund të kalohej nata.

Aleksandër Popoviçi ka dhënë për bektashizmin përkufizimin e përmbledhur por efikas të një feje, e cila është një sinkretizëm i dalë nga shiizmi dhe i ndikuar ndër të tjera nga krishtërimi. Bektashizmi buron nga një prej doktrinave mistike të baballarëve turkmenë, të përhapura në shekujt XI-XII që nga deti Kaspik deri në

Anadoll. Themeluesi i tij është Haxhi Bektashi, edhe ai një baba turkmen, i ndikuar shumë nga doktrinat e mistikut persian Ahmet Jasevi. Bektashizmi zhvillohet në Turqi, ku me kalimin e kohës, merr një kuptim të rëndësishëm politik sepse është i lidhur ligjërisht me korpusin e jeniçerëve. Si doktrinë, bektashizmi ka shumë elementë shiitë, të cilat ai nuk ngurron t’i radikalizojë në mënyrë të skajshme. Adhuron Aliun jo më pak se Muhametin, deri në hyjnizimin e tij. Në teologjinë e bektashinjve, Aliu shfaqet ngandonjëherë edhe në një triadë të vetme me Muhametin dhe Allahun. Me të tilla premisa, bektashinjte, që u zhvilluan në Anadoll, si një urdher dervishësh, nuk mund të mos hynin në konflikt me Islamit zyrtar. Nuk të habit toleranca dhe mirëkuptimi

i bektashinjve ndaj jo myslimanëve, sepse ishin shokë të një opozite ideore.

Marrëdhëniet ndërmjet bektashinjve dhe të krishterëve duhet të kenë qenë mjaft të dendura. Në të vërtetë jeta fetare e bektashinjve kishte shumë pika takimi me krishtërimin, sa që dukej si e studiuar enkas për të pranuar të krishterët të cilët, pasi e kishin adoptuar nga ana e jashtme besimin islamik, për oportunitet ose nën shtrëngimin e mjedisit, do të dëshironin të pajtoheshin përsëri me besimin dhe doket kristiane. Lidhja me jeniçerët, duke pasur parasysh prejardhjen kristiane të këtyre, do të ishte një provë e mëtejshme e rolit të veçantë të bektashinjve në tranzicionin kompleks dhe shekullor të kaq populatave nga Krishtërimi në Islamin.

Ka paralelizma të ngushtë midis praktikave fetare të bektashinjve dhe atyre kristjane. Ritet e bektashinjve riprodhonin pak a shumë me besnikëri, deri gjashtë nga shtatë sakramentet kristiane. I vetmi sakrament që nuk pranohej ishte vajimi i të sëmurëve. Një lloj konfirmimi praktikohet me ujë trëndafili, ndërsa Eukarestia kremtohej me bukë dhe verë, duke e njohur edhe si simbol i vdekjes së Jezu Krishtit.

Ekzistonte një pendesë me zgjidhjen përkatëse të mëkateve dhe nuk mungonte edhe diçka e ngjashme me çkishërimin që praktikonin kishat kristiane. Urdhëri priftëror gjente një paralel me babatë beqarë, të cilët, megjithatë, mund të krahasohen më shumë me murgjit sesa me një kler shekullar. Nuk është e vështirë të vazhdohet gjatë me analogji të tilla. Veç elementëve shiitë dhe lidhjeve me krishtërimin, bektashinjët i kalonin njëri-tjetrit me traditë gojore një doktrinë të fshehtë, e cila, ndër të

tjera, ishte nxjerrë nga pasuria e tarikateve të ndryshme islamike heterodokse (kështu ndodhte edhe me teoritë kabalistike të prejardhura nga Harufët). Besonin në metempsikozën dhe si tendencë ishin panteistë. Predikonin barazinë ndërmjet burrit dhe gruas dhe e praktikonin (për këtë ishin edhe më të pëlqyeshëm për Islamin ortodoks). Silleshin lirisht ndaj shumë ndalimeve kuranike (pinin alkool dhe e pakësonin Ramazanin në disa ditë).

... Organizimi i bektashinjve në Shqipëri në shekullin XX bazohej në rrjetin e lartpërmendur të teqeve të përhapura në tërë vendin dhe të vetëmjaftueshme përsa i përket pasurisë së disponuar. Deri më 1922 bektashinjët shqiptarë vazhduan t'i bindeshin autoritetit më të lartë të urdhërit dedeit të madh, i cili e kishte selinë në Turqi. Atë vit një kongres i bektashinjve shqiptarë shpalli zyrtarisht autonominë e tyre. Duhet thënë se në një farë mënyre bektashinjët shqiptarë ishin edhe më parë autonomë, sepse brenda sektit kishin një mbizotërim absolut. Vetë dedei i madh i asaj kohe ishte shqiptar, sikurse me prejardhje shqiptare ishin edhe eprorët e shumë te-

qeve jashtë Shqipërisë. Më 1923 ky e braktisi selinë qendrore të bektashinjve në Turqinë e Ataturkut dhe u strehua në Tiranë, kështu që ky qytet, dy vjet më vonë u bë zyrtarisht qendra botërore e bektashinjve.

Përhapja e bektashizmit në Shqipëri në shekullin XX përfshinte sidomos zonat jugore të vendit. Nga veriu bektashinj kishte pothuajse vetëm në Krujë. Në Shkodër nuk kishte sepse në fillim të shekullit të kaluar ata ishin përdorur nga veziri i Epirit, Ali pashë Tepele, si agentë dhe spiunë të tij. Ky guvernator i Epirit edhe ai i lidhur me bektashizmin mundi të krijojë në gjirin e perandorisë osmane, siç dihet, një lloj shteti të pavarur ku përfshihej edhe një pjesë e madhe e Shqipërisë. Në Shkodër ishte kundërshtari i tij Mustafa pashë Bushatliu, i cili u kujdes t'i përzinte bektashinjët nga qyteti. Pozitat politike të bektashinjve shqiptarë janë veçanërisht interesante. Në fund të shekullit XIX ata përqafulan çështjen e pavarësisë kombëtare. Në këtë zgjedhje kontribuan marrëdhëniet tradicionalisht të vështira me autoritetet politiko fetare të Bosforit, por edhe hapja e tyre karakteristike ndaj sensi-





bilitetit të bashkëkohësve dhe ndaj ideve të reja. Ndërmjet bektashinjve dhe katolikëve mund të gjenden patriotët më të mëdhenj shqiptarë në epokën e luftërave për pavarësi. Në urdhrin dervish bënte pjesë Naim Frashëri i cili teorizonte haptas pajtimin midis patriotizmit dhe fesë. Në një shkrim të tij të vitit 1896 lexohet: "Jo vetëm ndërmjet tyre, por edhe ndaj gjithë njerëzve bektashinjë janë vëllezër... Ata i duan myslimanët e tjerë dhe të krishterët si shpirtin dhe sillen me të vërtetë mirë me të gjithë njerëzit. Por sidomos duan atdheun dhe miqtë e atdheut, sepse ai është pasuria më e madhe".

Vrojtues të ndryshëm të realitetit shqiptar të viteve 1920 dhe 1930 dallonin në orientimet dhe në stilin e jetesës së bektashinjve një sfond thjesht perëndimor. Sigurisht bektashinjë ishin njerëz jo të mbyllur ndaj modernitetit, shoqërisht dinamikë, larg nga një farë pasiviteti të masave myslimane shqiptare të asaj kohe. Nuk e përbuznin përparimin shkencor, të cilin ata orvateshin ta fusnin në Shqipërinë e prapambetur, duke filluar që nga babai i një teqeje në Krujë, i cili, në fund të shekullit XIX, bleu në Trieste makina bujqësore kaq moderne sa që fshatarët e rrethinës u frikësuan dhe i shkatërruan duke i pandehur vepra të djallit.

Duhet shtuar, nga ana tjetër, se pjesëtarët më të vetëdijshëm të bektashizmit, domethënë dervishët që banonin në teqetë, vinin jo rrallë nga radhët e borgjezisë së pakët shqiptare dhe të bejlerëve të

vegjël, kështu që ishte e natyrshme që urdhri, në tërësinë e tij, të kishte prirje për pranimin e modernitetit dhe që të kishte në radhët e veta një përqindje të mirë intelektualësh. Studime të kohëve të fundit kanë mbështetur hipotezën e një lidhjeje midis bektashizmit dhe masonerisë perëndimore, çka do të përforconte idenë e një pozicionimi të tyre jo larg vlerave dhe mendimit perëndimor.

Sinkretizmi fetar i bektashinjve, disa ngjashmëri të tyre me krishtërimin, toleranca e tyre dashamirëse ndaj feve të tjera sipas parimit të ekzistencës së një Perëndie të vetme të pranuar njësoj nga besimet më të ndryshme, të gjitha këto krijojnë mendimin jashtë Shqipërisë se bektashinjë do të mund të përbënin një lëvizje që do të lidhte bashkësitë e ndryshme fetare të këtij vendi të vogël ballkanik. Nga ana tjetër shartimi i elementëve të mendimit dhe të sjelljes perëndimore në trungun e një spiritualiteti lindor të bënte gjithashtu të mendoje se ata do të mund të përfaqësonin një faktor bashkimi të popullsisë shqiptare, e ndarë dhe përjetë objekt lakmish midis Lindjes dhe Perëndimit. Ata thuhej në fund të fundit përhapnin fenë e vërtetë dhe ideore të shqiptarëve: në asnjë vend tjetër bektashizmi nuk kishte arritur një përqendrim të tillë ithtarësh dhe besimtarësh, ç'ka tregonte se ai e kishte kuptuar mirë shpirtin shqiptar. Si konkluzion propozohet që bektashizmi të ngrihej si një lloj kishe kombëtare shqiptare.

Më 1929, në një periudhë kur politika italiane duke e interesuar për konsolidimin e regjimit të Zogut dhe ishte ende e largët koha e pushtimit fashist, gjeografi dhe natyralisti italian Antonio Baldaçi, studiues i Shqipërisë dhe këshilltar përkatës i qeverisë italiane, mendonte se problemi i ndarjes fetare të shqiptarëve ishte nga më të rëndët për qëndrueshmërinë e mbretërisë së Zogut. Zgjidhja që ai propozonte ishte thjesht ajo e unifikimit të vendit rreth bektashizmit ose katolicizmit. Katolikët kishin disa shanse për t'i dalë mbanë, sepse përbënin një bashkësi fetare të organizuar më mirë dhe me një ndjenjë më të spikatur identiteti, pa dyshim më të lartë se ajo e myslimanëve sunitë dhe e ortodoksëve. Kurse bektashizmi kishte nga ana e tij, sipas Baldaçit, aftësinë për të mishëruar në mënyrë autentike shpirtin shqiptar.

Vendi që bektashinjtë zënë ndër fetë e Shqipërisë është i caktuar mirë: ata nuk janë, ta marrësh hollë-hollë, as si myslimanë as si të krishterë. Bektashinjtë do të përfaqësonin atë tip feje që u përshtatet më shumë ndjenjave patriarkale të racës shqiptare, dokeve dhe zakoneve të popullsisë vendase, të paçkombëtarizuar... doktrina e ngritur dhe mistike e bektashizmit do të kishte fuqinë për të krijuar një numër shumë të madh ithtarësh pa prekur në asnjë mënyrë ndërjegjen fetare të të tjerëve. Patriotët e vërtetë shqiptarë dhe kryesisht myslimanët sunitë, nuk do të mungonin të aderonin dhe të bëheshin ata vetë instrumente në kuptimin nacionalist të dëshiruar.

Feja myslimane sunitë, të cilën shqiptarët e përqa-fuan dhe e toleruan për një interes material të

llogaritur, mund të konsiderohet si e perënduar me dëbimin e turqve. Prandaj, e ardhmja e bektashizmit në Shqipëri do të duhej të shtrohej nga të gjithë ata që e duan vendin, si një mjet për të zgjeruar rrugën drejt atij paqësimi fetar që është strumbullari i përparimit të gjithë rajonit. Me një ndjeshmëri tjetër dhe me simpati jo të painstrumentalizuar për projekte politike, Margaret Hasllëk argumentonte po në ato vite të Baldaçit, se bektashizmi do të bëhej feja e të gjithë shqiptarëve...

Ishte një paraqitje e idealizuar e bektashizmit. Në realitet dervishët e urdhrit nuk ishin të orientuar me pasion drejt vlerave të Perëndimit, por ruanin shumë nga tiparet lindore të origjinës së tyre. Nuk i referohem vetëm ose aq shumë pamjes së tyre të jashtme, me një sërë kamash në brez ose me vathët e rëndë me të cilët kishin qejf të stoliseshin. Megjithatë bektashinjtë gëzonin respektin e popullatës si "njerëz të fesë", elitarizmi i tyre shpirtëror ekzotik i largonte nga masa. Edhe mendimi i tyre fetar prirej të formësohej si një sërë konceptesh të përgjithshme, nga dashuria panteiste për të gjithë njerëzit dhe për natyrën tek dashuria, historikisht më e përcaktuar, për atdheun e vet. Bektashinjtë nuk ishin të gatshëm të konceptonin formula organizative dhe struktura të ndryshme nga ato të një sektit a shoqate të fshehtë në të cilën kishin jetuar me shekuj.

Universalizmi i bektashinjeve ishte një aspiratë shpirtërore dhe jo një projekt i përcaktuar. Kësaj mund t'i shtohet se në Shqipërinë e mbretit Zog po çante rrugë së bashku me afirmimin e mundimshëm

të një shteti laik dhe të një farë përparimi në arsimin publik, edhe një proces shekullarizimi sidomos në popullsinë shqiptare më me kulturë, duke përfshirë dukshëm edhe besimtarët e bektashizmit.

Ky i fundit, gjithsesi, përfaqëson në Shqipërinë e atyre viteve një Islam alternativ, më liberal dhe më pak formalist, duke përbërë një çarje të thellë në ortodoksinë islamike të vendit.



Duajë atë që do Zoti yt !

Nga Nevila Nallbani


Pas përvojave të mëparshme që kombinuan vështirësitë e thella me gëzimin e pa përshkruar, filloi lëvizja e fundit më e madhe e Muhamedit (s.a.s). Ky ka qenë migrimi në Jethrib, qytetin që do quhej më vonë Madinat al-nabi ("Qyteti i Profetit") dhe përgjithmonë do të njihet si thjesht Medina.

Në historinë njerëzore, disa personazhe dhe vende fetare kanë arritur një status ikonik që brenda botës së tyre fetare, referohen si një emër i duhur. Ka shumë të cilët kanë qenë spiritualisht të zgjuar, p.sh. nëse flasim për "një të zgjuar" atëherë bëhet fjalë për Budën. Në Bibël ka shumë që janë të bekuar, por fjala "Krisht" i referohet vetëm Jezusit. Po njësoj është edhe për "të Dërguarin". Gjatë historisë së njerëzimit ka pasur profetë dhe të dërguar të panumërt, por në kozmosin spiritual nëse flasim për të Dërguarin e Zotit bëhet fjalë për Muhamedin (s.a.s) dhe "Qyteti" në këtë kozmos spiritual i referohet

vetëm Medinës. Më parë kemi përdorur analogjinë e Mekës si zemra e komunitetit islamik, vendi në të cilin komuniteti kthehet për tu ripërtërirë. Në këtë analogji, roli i Medinës është të shërbejë si mushkëritë e komunitetit, si vendi në të cilin komuniteti rikthehet për tu inspiruar- fjalë për fjalë për tu mbushur me frymë (etimologjikisht lidhet me fjalën tonë "frymëmarrje")- jo vetëm nëpërmjet Zotit, por gjithashtu edhe nëpërmjet vetë Muhamedit (s.a.s). Edhe sot shumë pelegrinë përshkruajnë pelegrinazhin në Mekë si një eksperiencë dramatike dhe frymëzuese, por duhet shtuar se Medina ka një bukuri dhe ëmbëlsi të veten, një "aromë" të cilën e lidhin me Profetin. Shumë myslimanë, veçanërisht ata nga Azia Jugore kanë shkruar poezi të bukura dhe të përzemërta që shprehin lutjet e tyre për t'iu dhënë mundësia të vizitojnë Medinën qoftë vetëm një herë dhe të mbushen me prezencën e Muhamedit (s.a.s). Për shumë pasues të Muhamedit (s.a.s), Medina do të jetë gjithmonë "Qyteti i Profetit."

Migrimi i Muhamedit (s.a.s) në

Medinë njihet ndryshe si hixhreti dhe është ndër ngjarjet më thelbësore në historinë islame. Ia vlen të përmendet se kalendari islamik nuk fillon me vitin e lindjes së Muhamedit (s.a.s) (sic nis kalendari




kristian me lindjen e Krishtit), as nuk fillon me nisjen e shpalljes nga Zoti për Muhamedin (s.a.s). Por, fillon me këtë lëvizje, lëvizjen e tretë dhe finale të revolucionit Muhamedan. Lëvizja horizontale nga Meka në Medine do të ndërtonte një komunitet shembull nën ligjin dhe kujdesin e Muhamedit (s.a.s). Dhe si gjithë revolucionet e tjera në kuptimin e plotë të fjalës, gjendet një trajektore në të, një rrotullim që ecën para dhe kthehet pas. Shkakton, ashtu siç duhet, një kthim përfundimtar në shtëpi si dhe një spastrim të asaj origjine.

Paganët e Mekës vazhduan sërish me persekutimin e Muhamedit (s.a.s) dhe pasuesve të tij, të cilët e kuptuan që armiqtë ishin përshkallëzuar. Ndërkohë që në fillim persekutimi prekte direkt anëtarët e marginalizuar të komunitetit të Muhamedit (s.a.s), tashmë kishte shenja të qarta që vetë jeta e Muhamedit (s.a.s) ishte në rrezik të madh. Në fakt, mekasit po planifikonin vrasjen e shpejtë të Profetit. Në këtë kohë një mirësi trokiti në derën e tyre: një komunitet nga Jethribi, qytet dyqind milje larg Mekës (akoma nuk njihet si "Qyteti"), erdhën tek Muhamedi dhe i ofruan besnikërinë atij duke i kërkuar Profetit të

vinte tek qyteti i tyre për ta ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve të tyre fisnore. Ata kanë qenë mjaft të impresionuar nga cilësitë e Muhamedit (s.a.s) si Amin (i Besueshmi) dhe e shikonin atë si një person me urtësi solomonike, të denjë për të gjykuar mbi ta. Muhamedi në fillim dërgoi disa nga pasuesit e tij në Jethrib, ndërsa ai qëndroi nga pas. Për tu çuditur, shumë nga personat të cilët e ngacmonin dhe persekutojnë Muhamedin (s.a.s) ende i besonin atij sendet e tyre. Mbi të gjitha, Muhamedi ishte njohur si Amin edhe ndaj armiqve të tij. Muhamedi nuk largohej kurrë nga Meka pa i dorëzuar të gjithë sendet personave që i kishin besuar atij.

Pasi Hatixhja ndërroi jetë, dy miqtë e ngushtë të Muhamedit (s.a.s) ishin Aliu- një djalosh i fuqishëm dhe Ebu Bekri, një plak i respektuar i komunitetit. Të dy luajtën role të rëndësishme në këtë migrim. Muhamedi e ngarkoi Aliun me detyrën e rrezikshme për të fjetur në krevatin e tij ndërkohë që banda e vrasësve priste jashtë shtëpisë së Profetit. Paganët e Mekës kishin thurur një plan shumë të zgjuar: një i ri nga secili klan do të bashkohej në vrasje që në këtë mënyrë të siguroheshin që asnjë klan i vetëm nuk do të vihej në shënjestër për ndëshkim. Por siç e thotë edhe Kur'ani: Përkujto (o i dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje; të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë. Ata bënin plane, e Allahu i asgjësonte, se Allahu është më i miri që asgjëson (dredhitë). (Kur'an 8:30)

Këtu qëndronte esenca e planit të Zotit: Muhamedi do të largohej drejt Jethribit nën mbulesën e natës, ndërkohë që kalorësi Ali do të zinte vend në shtratin e Profetit dhe do të përballej me rrezikun e vrasjes së tij. Muhamedi e mbuloi Aliun me pelerinën e tij të gjelbërit dhe i tha të përsëriste një ajet të sures Jasin si mbrojtje. Sipas traditës, Muhamedi hodhi pluhur në kokat e grupit vrasës, duke i verbuar ata për një moment. Kjo thuhet të jetë kuptimi i ajetit të Kur'anit (36:9): "Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin."²⁴ Ndërkohë, Muhamedi dhe Ebu Bekri morën udhën drejt Jethribit. Kur dolën jashtë qytetit, Muhamedi shikoi me dashuri Mekën dhe tha: "Në të gjithë tokën e Allahut, ti je vendi më i dashur për mua, dhe më i dashuri për Zotin. Nëse njerëzit e mi nuk do më detyronin të largohem, kurrë nuk do të të lija ty."²⁵ Hixhreti nuk ishte as braktisje e Mekës dhe as harresë se nga kishte ardhur secili. Ka



qenë vendosmëria për tu ngritur nga shtypja me qëllim rikthimin përfundimtar për tu përballur me shtypësit.

Vrasësit paganë ndoqën Muhamedin (s.a.s) dhe Ebu Bekrin dhe u afruan shumë për të gjetur ata. Disa tradita raportojnë se gjatë hixhretit, Muhamedi dhe Ebu Bekri u fshehën në një shpellë për tre ditë. Sipas këtyre shpjegimeve, Zoti mrekullisht mbuloi pjesën para shpellës me rrjetë merimange dhe vendosi një pëllumb në një pemë afër shpellës. Me fjalë të tjera, dukej si një hyrje që askush nuk mund të kishte hyrë brenda nëpërmjet saj. Padyshim ekziston diçka simbolike në këto sqarime: rrjeta e merimangës është diçka njëherësh zburim dhe e tejdukshme- e bërë nga substancat më të forta në fushën natyrore. I tillë ishte plani i Zotit: e njëjta krijesë mund të jetë shëmbëlltë e bekimit ose e rrënimit. Këtu rrjeta e merimangës shpëtoi jetën e Profetit dhe në një vend tjetër në Kur'an shtëpia e merimangave është marrë si një parabolë për ata të cilët mbështeten për mbrojtje në qeniet e tjera e jo në Zot (Kur'an 29:41). E njëjta metaforë mund të ketë kuptime të shumta në shkri- met e shenjta që kanë shtresa të pafund kuptimesh. P.sh., pëllumbi që qëndroi në hyrje të shpellës, më parë në kohët biblike pëllumbi ka qenë simbol i shpirtit.

Muhamedi përfundimisht arriti në Jethrib, ku e pritën me gëzim dhe poezi të bukura të kompozuar në nder të Profetit. Aliu gjithashtu do të bashkohej me ta pas disa ditësh. Për tre ditë të tëra ai u mor me shpërndarjen e mallrave që armiqtë e Muhamedit (s.a.s) dhe të tjerët i kishin be-

suar atij, një tregues i mëtejshëm i nivelit të besimit që të gjithë ata kishin në vetë personin të cilin po e persekutonin. Kur Muhamedi arriti në Medinë, takti i tij ishte i thjeshtë atje, një përkujtim i nevojës për të lidhur aktet e adhurimit me kujdesin për të varfrin:

O njerëz, përshëndeteni njëri-tjetrin me Paqe (Selam);

Ushqejini të uriturit;

Nderoni lidhjet farefisnore;

Lutuni në orët e vona kur të tjerët janë në gjumë.

Kështu do të hyni të qetë në Parajsë. 26

Veprimi i parë i përbashkët në Medinë ishte ndërtimi i Xhamisë, në fakt xhamisë së parë mysli- mane. Ishte një xhami e thjeshtë, e ndërtuar përmes bashkëpunimit të shumë prej besimtarëve. Trunget e disa palmave i përdorën si shtylla për të mbështetur degët e palmave që krijonin strehë nga dielli, por pjesa më e madhe e oborrit u la e hapur- një model që do të ndiqej në pjesën më të madhe të botës islame. Vetë Muhamedi ndihmoi në ndërtimin e xhamisë dhe gjatë punës recitonte këtë varg poezie:

Nuk ka jetë veç jetës në botën tjetër,

O Allah, ki mëshirë për Ansarët dhe për Muhaxhirët. 27

Një nga mënyrat në të cilat mëshira e Zotit u lëshua mbi Ndihmësit (Ansarët, ata nga Medina të cilët e pritën Profetin) dhe Migrantët (Muhaxhirët, ata të cilët e shoqëruan Muhamedin (s.a.s) nga Meka) ishte nëpërmjet lidhjes së vëllazërisë. Deklarata e parë e Muhamedit (s.a.s) ishte të ndryshohej struktura shoqërore e komunitetit të Jethribit (tashmë Medinës). Profeti bashkoi çdo anëtar të ndihmësve me një anëtar

të migrantëve për të krijuar kështu një lidhje të besimit që tejkalonte dhe përmbyste lidhjet fisnore dhe statusin e klasës socio-ekonomike. Vëllai besimtar i vetë Profetit nuk ishte askush tjetër veç Aliut.

Në njërin ndër fjalimet e tij të para, Muhamedi predikoi këto fjalë:

Lavdia i takon Allahut, të cilin unë e adhuroj dhe u kërkoj edhe juve ta adhuroni.

Strehohemi tek Allahu nga vetë mëkatet tona dhe nga të këqijat e veprave tona.

Atë të cilin Zoti e udhëzon, asnjë nuk mund ta largojë nga rruga e drejtë;

Dhe atë të cilin e humbet, askush nuk mund ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut.

Dhe ai është i pakrahasueshëm...

Duaje atë që do Zoti yt.

Duaje Zotin me gjithë zemër,

Mos u lodh nga fjala e Allahut dhe përmendja e tij.

Mos ngurtëso zemrën tënde ndaj tij...

Duajeni njëri-tjetrin për hir të Allahut.

Në të vërtetë Allahu zemërohet kur Besa e tij thyhet.

Paqja qoftë mbi ju. 28

Ky komunitet ishte i bazuar në besimin në Allah dhe dashurinë për njëri-tjetrin "për hir të Zotit," ashtu siç ky fjalim i porositi ata. Në Medinë kornizat e përgjithshme morale të mësimëve të Muhamedit (s.a.s) u ndërlihdën me një seri të plotë të urdhrave etike, ligjore dhe sociale. Mysli- manët janë lutur që në kohën e Muhamedit (s.a.s), Hatixhes dhe Aliut, por ka qenë në Medinë, ku lutjet (namazet) e përbashkëta u ofruan ditëve të premtë. Arabët kanë qenë të njohur me imazhin

e shtyllave që mbajnë tendat dhe Muhamedi përdori këtë imazh për të përshkruar mënyrën në të cilën besimi mbahet dhe mbështetet. Në qoftë se besimi në Zot (Shahada) ishte shtylla e besimit, në Medinë pikërisht kjo shtyllë u transformua në një vendbanim të plotë- vendbanimin e islamit.

Madje edhe ajetet e shpallura për Muhamedin (s.a.s) filluan të ndryshojnë natyrën e tyre në Medinë. Suret e shpallura në Mekë kanë qenë suret e shkurtra, shpesh apokaliptike në natyrë që flasin rreth fundit të ditëve. Në Mekë Kur'anit fliste në mënyrë poetike dhe të fuqishme rreth mënyrës si toka do të përmbysset, një përshkrim i ngjarjes që parashikohet të ndodhë Ditën e Gjykimit dhe një përshkrim simbolik se si revolucioni Muhamedan po përmbyste dhe po trazonte modelet fisnore dhe politeizmin fetar të "rrugës së të parëve".

Por, kjo nuk ishte e mjaftueshme për tu përmbysur kaq thjeshtë; diçka duhej të ofrohej në këmbim, diçka më e dhembshur, më bujare dhe më e bukur. Këto mësimë u ofruan në Medinë. Vargjet e Kur'anit të shpallura në Medinë adresuan shumë pyetje të domosdoshme me të cilat komuniteti i ri po përballlej- pyetjet e martesës dhe vdekjes, trashëgimisë dhe divorcit. Nëse në Mekë myslimanët përballëshin kryesisht me paganët, këtu ata duhej të pajtoheshin

me prezencën e çifutëve dhe të krishterëve. Kështu, shumë sure të Kur'anit të shpallura në Medinë trajtojnë narrativat biblike të profetëve që janë të njohura për ne nga Bibla. Në fakt, skolastikët Kur'anor më vonë kanë ndarë Kur'anin në suret e shpallura në Mekë (Makki) dhe ato të shpallura në Medinë (Madani). Supozimi i nënkuptuar është se nuk mund të kuptosh domethënien e ajeteve të pasura të shkrimeve të shenjta pa ditur diçka në lidhje me kontekstin në të cilat- dhe shpesh kundër të cilave- janë shpallur.

Shumë persona të cilët e lexojnë Kur'anin për herë të parë befasohen kur gjejnë përkrah sureve të cilët diskutojnë mëshirën dhe dhembshurinë e pafund të Zotit- të tilla si Zoti është më afër nesh, p.sh., se vetë damarët e qafës sonë (Kur'an 50:16)- gjenden edhe sure të cilat janë shpallur gjatë periudhës që Muhamedi merrej me "hipokritët": ata që gënjen, tradhtuan dhe mashtruan dhe ata të cilët godisnin në shpinë komunitetin e sapokrijuar, ndërkohë që pretendonin të përkrahnin misionin e Muhamedit (s.a.s). Pa marrë parasysh kontekstin, këto ajete mund të duken të çuditshme apo edhe mizore. Ne tani do të kthehemi në kontekstin e trazuar të politikave të diskutueshme në të cilat Muhamedi e gjeti veten të ngatërruar në vetë qytetin që do të kujtohej përherë si Qyteti i tij.



WE APPRECIATE YO



The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, participated at the meeting on the problems of the democracy and the human rights, in the States Department of the United States of America

After the invitation of the States Department of the United States of America, the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, participated, recent days, at the meeting on democracy, security, human rights and other priorities, in the context of the recent religious developments. A deep analysis of the actual situation and the presentation of different opinions regarding the actual challenges,

characterized the works of this activity, which had, naturally, the global sensitivity towards actual multifarious tendencies. The ways followed until now were analysed through ideas and practices, for today and for the future, aiming the solution, as immediately as possible, of the challenges which are facing actually the democracy and the basic human rights.

In the opening of this meeting, Mrs. Patricia Davis, Bureau Director, brought to the attention of the participants the interest and the deep appreciation of the States Department on these issues and she spoke particularly about the intellectual potentialities disposable for the solution of the problems in this sense.

While Mr. Michael Kozak, presented several valuable experiences regarding the practice of the religious freedom and the basic rights. The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, spoke also about those basic religious rights. In his speech, the World Bektashi Grandfather spoke about the religious rights in Albania and further he mentioned the case of the religious objects in FYROM, especially about the teke "Harabati-Baba", in Tetovë, where, since many years, for the Bektashi believers is not possible to freely exercise their faith and their traditional practices.

Although the World Bektashi Head Quarter informed the public opinion and denounced the usurpation of the spaces of the Bektashi teke by the Islamic extremists, although the international opinion is already sensitive about because of the information by the diplomatic representatives in Skopje, although the Strasbourg Court demanded the removal of the usurpers, the official authorities of FYROM remain indifferent.

The World Bektashi Grandfather Haxhi Dede Edmond Brahimaj, informed the presents at this activity that the Bektashi faith, since its origin and especially in the centuries XIV and XV, was able to be extended, step by step, in Balkan areas and to gain spiritual and geographical ground, only through its peaceful doctrine, nourishing peace and fraternity between different religious communities

UR CONTRIBUTIONS

The World Bektashi Grandfather Haxhi Dede Edmond Brahimaj, informed the presents at this activity that the Bektashi faith, since its origin and especially in the centuries XIV and XV, was able to be extended, step by step, in Balkan areas and to gain spiritual and geographical ground, only through its peaceful doctrine, nourishing peace and fraternity between different religious communities and between different ethnic communities, which were often united and divided by the winds of the history, many times in hostile situations. The Bektashi clergymen, the ancient and the actual ones, following the tracks of their spiritual leader, Haxhi Bektash Veli, try to learn their millions of followers that the saint love to the Creator is not accepted or identified without the religious fraternity, the spirit which keeps alive the peace between the peoples.

and between different ethnic communities, which were often united and divided by the winds of the history, many times in hostile situations. The Bektashi clergymen, the ancient and the actual ones, following the tracks of their spiritual leader, Haxhi Bektash Veli, try to learn their millions of followers that the saint love to the Creator is not accepted or identified without the religious fraternity, the spirit which keeps alive the peace between the peoples.

During this meeting, in the spaces of the States Department of USA, the World Bektashi Grandfather met many high official and religious personalities and discussed with them, as Giovanni Dazzo, Anne Bennett, Cranneth M. Davis, Amy Phiper, Sharon Duong etc. Mrs. Samantha Tu, director of the Program on Life Initiatives, interested on the actual developments in the Bektashi Holy See, was informed by the World Bektashi Grandfather about the conditions and situations in which the World Bektashi Centre was transferred from Turkey in Albania, as well as about the efforts of the Bektashi clergymen to preserve and to defend, even with sacrifices, the Albanian language, the national consciousness and even the menaced destinies of Albania. Mrs. Tu shared with the World Grandfather the idea that all the religious leaders are defined not by the titles or by the uniforms, but by their love and devotion to the Creator and by the spirit of the fraternity that they diffuse among the believers. While Ambar Riaz Zobairi, Minister of the Religion in Northern Africa, after discussing with the World Bektashi Grandfather and taking into consideration what the participants at this meeting expressed on the Bektashism, concluded his speech: "In the actual religious world is not very important the numerical superiority of the believers. There are provisions and clauses regulating the conditions of the exercise of the religious freedom, which are inclined to take care even for the numerically small religious communities. Actually, the force of every faith is generated by the contribution which it represents and transmits, for the good of the construction of the best models, accompanied by the universal moslem comprehension. In this framework, we highly appreciate and estimate your contributions".

Corresp. "Urtësia" (The Wisdom)

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.129 DHJETOR 2018

*Ejthë dashamirësue dhe
bashkëpunëtorëve të Urtësisë*

Januar 2019!